



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

**VEPRIMTARI MËSIMORE SUGJERUESE
BAZUAR NË KURRIKULËN E MËSIMIT
PLOTËSUES NË DIASPORË**

Korrik, 2016



TABELA E PËRMBAJTJES

Tabela e Përmbajtjes	2
Veprimtari Mësimore Sugjeruese Bazuar në Kurrikulën e Mësimit Plotësues në Diasporë	3
Modele Veprimtarish në Ndhimë të Mësuesve për Zbatimin e Kurrikulës për Mësimin e Gjuhës Shqipe në Diasporë	6
Lënda GJUHE SHQIPE	6
2.1 Veprimtari Mësimore Nr. 1	6
2.2 Veprimtari Mësimore Nr. 2	8
2.3 Veprimtari Mësimore Nr. 3	14
2.4 Veprimtari Mësimore Nr. 4	18
2.5 Veprimtari Mësimore Nr. 5	21
2.6 Veprimtari Mësimore Nr. 6	26
2.7 Veprimtari Mësimore Nr. 7	29
2.8 Veprimtari Mësimore Nr. 8	32
2.9 Veprimtari Mësimore Nr. 9	36
Lënda HISTORI	42
3.1 Veprimtari Mësimore Nr. 1	42
3.2 Veprimtari Mësimore Nr. 2	43
3.3 Veprimtari Mësimore Nr. 3	45
3.4 Veprimtari Mësimore Nr. 4	47
3.5 Veprimtari Mësimore Nr. 5	49
Lënda GJEOGRAFI	53
4.1 Veprimtari Mësimore Nr. 1	53
4.2 Veprimtari Mësimore Nr. 2	54
4.3 Veprimtari Mësimore Nr. 3	58
4.4 Veprimtari Mësimore Nr. 4	59
4.5 Veprimtari Mësimore Nr. 5	60
Lënda ARTI PAMOR	62
5.1 Veprimtari Mësimore Nr. 1	62
5.2 Veprimtari Mësimore Nr. 2	63
5.3 Veprimtari Mësimore Nr. 3	64
5.4 Veprimtari Mësimore Nr. 4	65
5.5 Veprimtari Mësimore Nr. 5	66
5.6 Veprimtari Mësimore Nr. 6	67
5.7 Veprimtari Mësimore Nr. 7	68

VEPRIMTARI MËSIMORE SUGJERUESE BAZUAR NË KURRIKULËN E MËSIMIT PLOTËSUES NË DIASPORË

Për edukimin, zhvillimin dhe ruajtjen e identitetit kombëtar në programin e integruar të mësimin shqip në diasporë është mbajtur parasysh plotësimi i disa standardeve të domosdoshme.

Metodat që duhet të përdorë mësuesi në zbatimin e këtij programi duhet të jenë integrale, ndërvepruese dhe plotësuese të njëra-tjetrës. Ato duhet të mbështeten në karakteristikat e niveleve moshore, nivelin fillestar të formimit gjuhësor e kulturor të nxënësve, mënyrat e tyre vetjake të të nxënësve, kushtet dhe mjediset e të nxënësve në shkollën shqipe dhe në shtëpi, mënyrat e të nxënësve në shkollat që ata frekuentojnë në vendin ku jetojnë. Mësuesi duhet të krijojë një atmosferë nxitëse dhe argëtuese për nxënësit, që këta ta konsiderojnë ndjekjen e shkollës shqipe si një “punë” që u sjell kënaqësi. Ata duhet ta ndiejnë mungesën e saj dhe, në një farë mënyre, ta shikojnë si plotësuese të shkollës që ndjekin në vendin ku jetojnë, si dhe mbushëse të veprimtarive të kohës së lirë të tyre. Një mësues i përgatitur, krijues e me pasion, del jashtë kornizave të mësimdhënies standarde, duke u krijuar nxënësve një mjedis tërheqës e stimulues, me qëllim që këta ta vazhdojnë përvetësimin e programit në mënyrë sistematike.

Programi i integruar i mësimin shqip në diasporë përbëhet nga përmbajtje mësimore të disa lëndëve, të cilat integrohen me njëra-tjetrën. Integrimi realizohet në nivel horizontal dhe vertikal, nëpërmjet kompetencave kyçe dhe kompetencave të fushës/lëndës. Të njëjtat kompetenca të fushës/lëndës ruhen si brenda një shkalle, ashtu dhe, në kalimin nga një shkallë në tjetrën, gjë që mundëson lidhjen logjike dhe fleksibilitetin e zbatimit të programit.

Në zbatimin e programit ndihmon dhe përgatitja e nxënësve në lëndët përkatëse në shkollat që ndjekin aktualisht fëmijët. Është mirë që mësuesi të njohë programet e shkollave të vendit ku jeton.

Të gjitha metodat dhe teknologjitë e mësimdhënies për arritjen e rezultateve të të nxënësve të programit duhet të shihen të lidhura dhe në funksion të realizimit të rezultateve të të nxënësve të gjuhës shqipe dhe letërsisë. Kjo do të thotë se mësuesi duhet të studiojë dhe njohë mirë rezultatet e të nxënësve të programit në tërësi dhe jo vetëm ato sipas lëndëve përbërëse të tij. Meqë kjo kurrikul është e paraparë të realizohet në klasa të bashkuara (të kombinuara), të gjitha metodat, mjetet dhe format e punës i referohen një qasjeje të integruar, dhe ndërvepruese, me qëllim që nxënësi ta konsiderojë mësimin si një argëtim dhe kënaqësi.

Sa u përket formave tradicionale të punës, *puna në grupe (të madhësive të ndryshme), në çifte dhe posaçërisht ajo individuale* qëndrojnë para formës *frontale*.

Ndërkaq në fushën e metodave aplikohen me të njohurat si: *metoda e demonstrimit (shpjegimi, ligjërrata etj.), metoda e punës me tekst, metoda e bashkëbisedimit (diskutimet, debatet, shkëmbimi i mendimeve), metoda kërkimore-hulumtuese etj.*

Në fushën e teknikave të mësimdhënies dhe të mësimnxënies, tashmë në praktikën shkollore janë treguar shumë të suksesshme këto:

- *Brainstormingu ("stuhi, mendimesh", gjenerim idesh)*, që është teknike efektive e përshtatshme të përdoret në fillim të orës mësimore;

- *klasteri (grumbulli apo pema e mendimeve)*, që nxit nxënësit për të menduar rreth një teme të caktuar dhe shërben për të krijuar lidhje midis fakteve;
- *insert-i-*, si sistem ndërveprues i shënimit për të menduarit dhe leximin e efektshëm, që zakonisht përdoret në pjesën kryesore dhe është efektiv, sepse nxënësi është gjithmonë aktiv dhe mban qëndrim kritik ndaj asaj që lexon;
- *Xhigsou (ndërthurja)*, që është teknikë e të lexuarit në bashkëpunim, ku leximi i njësisë mësimore nuk bëhet në tërësi nga ana e të gjithë nxënësve, por nxënës të caktuar janë përgjegjës për pjesë të caktuara.

Një mori teknikash tjera si: *ditari dypjesësh, loja me role, diskutimi që zgjidh probleme, di-dua të di- mësova, rrjeti i diskutimit, diagrami i Venit, shkrimi i lirë, të mësuarit përmes projekteve, puna kërkimore në terren etj.*, të përdorura dhe në situata të përshtatshme didaktike, i shtojnë premisat për një sukses më të madh të mësuesit dhe të nxënësit.

Përmes tërësive tematike të dhëna në kurrikul, mësimdhënësi ndihmohet që të përqendrohet në tema konkrete për shkallë/nivele të caktuara. Megjithatë, në paralelen me klasë të kombinuara jo vetëm që kombinohet materia e këtyre fushave mësimore, por kombinohen edhe shkallët/nivelet e ndryshme të saj. Kështu në planin:

- gjuhësor* (nxënësi dëgjon, shkruan, lexon, reciton poezinë, e interpreton atë);
- letrar* (përjetohet figura, kuptohet dallimi poezi-tregim, shijohet gjuha e poezisë, edukohet shija, zhvillohet kompetenca përkatëse etj.);
- muzikor* (dëgjohej, këndohet dhe interpretohet në instrument muzikor);
- figurativ të arteve pamore* (nxënësit mund të vizatojnë, të ngjyrosin, të modelojnë flamurin, simbolet e tjera kombëtare etj., por mundet edhe të bisedojnë rreth ndonjë krijimi artistik ku temë është flamuri ose ngjarjet konkrete rreth tij);
- historik* (nxënësit mësojnë për flamurin dhe momentet historike të *lidhura me të në periudha të ndryshme të historisë kombëtare*);
- gjeografik* (nxënësit mund të bisedojnë e mësojnë për qytetet ose rajonet e ndryshme të Atdheut të lidhura me këto momente historike, pastaj mësuesi mund të organizojë edhe temat vijuese si p.sh. përdorimi i flamurit në institucione zyrtare, në familje dhe në festa që janë gjithashtu tema të veçanta në kuadër të tërësive tematike të propozuara).

Në këtë material ne kemi sjellë një set ***veprimtarish mësimore sugjeruese bazuar pikërisht në kurrikulën e mësimit plotësues në diasporë.*** Fushat kurrikulare në të cilat është punuar janë:

1. Gjuhë shqipe
2. Histori
3. Gjeografi
4. Arte

Tematikat rreth të cilave janë këto veprimtari mësimore janë nga secila prej katër fushave kurrikulare:

1. Identiteti im
2. Shqipëria në hapësirë dhe në kohë

3. Kultura dhe shoqëria
4. Një botë për tu zbuluar

Secila fushë/lëndë ka paraqitur **veprimtari për çdo tematikë**. Gjuha dhe artet kanë paraqitur më shumë se dy veprimtari për çdo tematikë.

Meqenëse në kurrikul është thënë se **fushat kurrikulare do të shihen të integruara** edhe këto veprimtari i kanë “kapërcyer” kufijtë e lëndëve përkatëse. Veprimtaritë mund të shfrytëzohen edhe si projekte që zgjasin një periudhë të caktuar kohore. Për sa i përket strukturës së këtyre veprimtarive mësimore ato kanë një strukturë të përcaktuar qartë, lineare dhe të thjeshtë, gjë e cila ndikon dhe në një përvetësim efikas nga ana e mësuesit.

Struktura e veprimtarive mësimore e paraqitur në këtë material është si më poshtë:

- **Titulli:** i cili mund të jetë nga përmbajtja në program ose një titull i krijuar;
- **Rezultatet e pritshme:** paraqesin pritshmëritë në fund të veprimtarisë mësimore dhe shërbejnë për të matur të nxënit e nxënësve;
- **Koha e sugjeruar:** mund të jetë edhe më shumë se një orë mësimore;
- **Fusha që integrohen:** jepen fushat e tjera të kurrikulës së diasporës që integrohen;
- **Materiale të nevojshme:** të cilat mund të jenë materiale didaktike, fletë pune etj.;
- **Zhvillimi i veprimtarisë:** hapat apo fazat e zhvillimit të veprimtarisë mësimore ku përfshihen si procedurat ashtu dhe teknikat/metodat e përdorura;
- **Ide për vazhdimësinë e veprimtarisë:** nënkupton ide se si mund të vazhdohet më tej për të kaluar në njohuri të tjera me synim që të lehtësohet mësuesi për të pasur një lloj vazhdimësie për më tej.

Veprimtaritë e mëposhtme në këtë material përmbajnë në vetvete pjesë letrare dhe jo letrare, shkrime të natyrave të ndryshme, përmes të cilave jepen informacione analizohen tekste dhe kërkohet që të bëhen veprimtari mësimore të natyrave të ndryshme duke lexuar, duke folur, duke shkruar, duke plotësuar tabela, duke gjetur ide dhe mesazhe që përcillen përmes tyre.

Për realizimin e këtij materiali/seti u angazhuan mësues me përvojë nga shkolla të ndryshme dhe punonjës të Institutit të Zhvillimit të Arsimit në Tiranë.

MODELE VEPRIMTARISH NË NDIHMË TË MËSUESVE PËR ZBATIMIN E KURRIKULËS PËR MËSIMIN E GJUHËS SHQIPE NË DIASPORË

Lënda GJUHE SHQIPE

2.1 Veprimtari Mësimore Nr. 1

Deklarata e Pavarësisë së Kosovës

(pjesë nga deklarata, tekst joletrar)

Të vendosur që ta shohim statusin tonë të zgjidhur në mënyrë që t'i jepet popullit tonë qartësi mbi të ardhmen e vet, të shkohet përtej konflikteve të së kaluarës dhe të realizohet potenciali i plotë demokratik i shoqërisë sonë,

Duke nderuar të gjithë burrat dhe gratë që bënë sakrifica të mëdha për të ndërtuar një të ardhme më të mirë për Kosovën,

Ne, udhëheqësit e popullit tonë, të zgjedhur në mënyrë demokratike, nëpërmjet kësaj Deklarate shpallim Kosovën shtet të pavarur dhe sovran. Kjo shpallje pasqyron vullnetin e popullit tonë dhe është në pajtueshmëri të plotë me rekomandimet e të Dërguarit Special të Kombeve të Bashkuara, Martti Ahtisaari, dhe Propozimin e tij Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës.

Ne shpallim Kosovën një republikë demokratike, laike dhe multietnike, të udhëhequr nga parimet e jodiskriminimit dhe mbrojtës së barabartë sipas ligjit.

Ne do të mbrojmë dhe promovojmë të drejtat e të gjitha komuniteteve në Kosovë dhe krijojmë kushtet e nevojshme për pjesëmarrjen e tyre efektive në proceset politike dhe vendimmarrëse.

Rezultatet e pritshme:

Nxënësi:

- lexon me kuptim fragmentin e dhënë për të marrë informacion;
- interpreton informacionin e tekstit të dhënë;
- tregon fakte nga historia e luftës për pavarësi të popullit të Kosovës ;
- analizon kuptimin e pjesës ;
- shpreh përshtypjet e tij në lidhje me tekstin;
- dallon fjalët dhe shprehjet që përdoren në tekst;
- analizon veçoritë gjuhësore-strukturore të tekstit të dhënë.

Koha e sugjeruar: dy orë mësimore

Lëndët që integrohen: Histori dhe gjeografi

Metodologjia: brainstorming, lexim teksti, praktikë e drejtuar, diskutim, punë në grupe.

Materiale burimore: projektor, teksti i nxënësit, foto të ndryshme, informacione nga interneti, etj.



Zhvillimi i veprimtarisë

Hapi i parë: *stuhi mendimi* (brainstorming). (10 min)

Mësuesja shkruan në tabelë temën dhe drejton pyetjet:

- Ç' dini për luftën për pavarësi të popullit shqiptarë të Kosovës?
- Kur e fitoi ai atë dhe si?

Hapi i dytë: *lexim i drejtuar* (15 min)

- Lexim (zinxhir) teksti.
- Nxënësit lexojnë dhe shohin në video projektor tekstin origjinal të deklaratës.
- Japin mendime dhe opinionet e tyre rreth deklaratës së pavarësisë së Kosovës.

Hapi i tretë: (20 min)

a. *Praktikë e drejtuar:*

- Për çfarë bën fjalë teksti i dhënë?
- Kur dhe ku është hartuar kjo deklaratë? Nga sa pjesë kryesore përbëhet ajo?
- Çfarë ka marrë parasysh hartuesi në pjesën e parë? Nga lind kjo deklaratë?
- Po pjesa e dytë për se flet?
- Ç' lloj teksti është. Pse?

b. *Punë e pavarur.*

c. *Kontrolli i punës së pavarur.*

Hapi i katërt: *Punë në grupe*

-Analizoni disa nga veçoritë gjuhësore të këtij teksti.

-Ç'vlera ka teksti i dhënë?

Kontrolli i punës në grup:

- nxënësit i drejtojnë pyetje njeri-tjetrit dhe japin mendimet e tyre për përgjigjet e dhëna nga secili.

Detyrë shtëpie: Gjeni material për paqen: foto me personalitete të paqes, thënie, këngë për paqen.

Vlerësimi i veprimtarisë mësimore : Veprimtaria mësimore quhet e realizuar kur nxënësit u japin përgjigje pyetjeve të mësuesit dhe të shokëve të klasës, kuptojnë dhe interpretojnë atë që kanë lexuar ose dëgjuar dhe japin mendimet e tyre në lidhje me çështje të caktuara gjatë orës së mësimit.

2.2 Veprimtari Mësimore Nr. 2

(fragment poezie)

Shkoi vera

.....Si hije,

Fryn era,

.....Shi bie.

Lart qielli

.....Si plumbi,

Shkoi dielli,

.....Na humbi.

S'ka jetë-

.....Ra brymë,

Bar, fletë

.....Pa frymë.

Asdreni (Alexander Stavre Drenova)

Tema: Pamje (A.S.Drenova)

Koha: 45 min

Rezultatet e pritshme

Nxënësi:

- lexon me kuptim fragmentin për të marrë informacionin e tekstit të dhënë;
- lexon në mënyrë shprehëse-emocionuese poezinë;
- përshkruan dhe të interpreton saktë me fjalët e tij (duke iu përmbajtur saktë përfytyrimit të autorit) peizazhin artistik në poezinë e dhënë;
- analizon saktë vargje nga ana ideoartistike;
- përshkruan saktë mesazhin dhe ndjenjën e autorit;
- gjen dhe emërton saktë figurat letrare: metaforë, krahasim, epitet etj.;
- përshkruan rolin e tyre artistik;
- analizon saktë elemente të ndërtimit artistik: strofa, vargu, rima;
- harton një ese përshkruese të tipit “peizazh artistik”, duke u mbështetur në modelin e poezisë së dhënë.

Koha e sugjeruar: dy orë mësimore

Fushat që integrohen: shkenca shoqërore dhe arte

Metodologjia: pema e mendimit, praktikë e drejtuar, stuhi mendimi, kllaster, bashkëbisedim, punë në grupe.


Materialet burimore: teksti, materiale nga interneti për jetën dhe veprën e Asdrenit, video-projektor, laptop, projektor etj.

Zhvillimi i veprimtarisë

Fjalë e shprehje kyçe: poezi, peizazh artistik, mesazh, ndjenjë, figura letrare, shpirtërizimi i natyrës etj.

Hapi i parë: *pema e mendimit.* (10 min.)

- Mësuesja shkruan në dërrasë titullin “Pamja”.
- I pyet nxënësit: Ç’mendoni se do të shtjellohet nën këtë titull?
- Për çfarë pamje mund të bëhet fjalë?
- Në formën e një kllasteri mësuesja shkruan fjalët e nxënësve:



Pasi merr dhe shkruan supozime të ndryshme ndalet tek “pamje natyre”.

Le të shohim disa foto.

(Mësuesi paraqet me anë të videoprojektorit fotot të marra nga interneti me pamje të ndryshme nga perëndimi dhe lindja e diellit si dhe nga stinë të ndryshme)

Mësuesi u drejton pyetje nxënësve:



-Çfarë paraqitet në këto foto?

-Ç’është perëndimi? Ç’ngjyra vihen re kur perëndon dielli? Mbi cilat objekte bien këto ngjyra?

-Ku i gjen ngjyrat perëndimi? Kush ia jep?

-Cila stinë ju pëlqen me shume? Pse?

-Sipas pamjeve që ofrojnë stinët, me çfarë ngjyrash do t'i identifikoni?

-A ju pëlqejnë fotot? Pse? Ç'ndjenja ju ngjallin?

-Në qoftë se e përfytyroni diellin si një qenie të gjallë, si një njeri që spërkat me të kuq malet, detin, xhamat e ndërtesave etj., si do ta karakterizoni? (piktor, bojaxhi,...)

Hapi i dytë: praktikë e drejtuar - prezantimi i poezisë dhe i veprës së autorit.

-A ju kujtohet poezia “Vjeshta” që kemi bërë vjet?

-Kush e ka shkruar këtë poezi?

-Kush do të më recitojë vargje të kësaj poezie?


-Ç' dini për jetën dhe veprën e Asdrenit?

-Në formën e një skede shkruaj në dërrasë ose shfaq me vidioprojektor:

Asdreni (A.S. Drenova)

Datëlindja: (1872-1947)

Vendlindja: Drenovë, Korçë




Emigroi 13 vjeç në Rumani, ku jetoi, punoi, u arsimua dhe u formua si shkrimtar.

Figurë e shquar e Rilindjes Kombëtare Shqiptare: atdhetar, kontribut për shpalljen e Pavarësisë, bashkëpunëtor i I. Qemalit dhe L. Gurakuqit

Vepra letrare: Poezi të ndryshme, nga e cila ka mbetur e pavdekshme “Betimi mbi flamur”, i cili u bë himni kombëtar i Shqipërisë.

Hapi i tretë: *klaster*

(20 minuta)



Bukuria e natyrës së Atdheut e ka frymëzuar përsëri poetin tonë të Rilindjes A.S. Drenova për të krijuar poezinë “Pamje”. Le ta zbulojmë se për ç’pamje e ka fjalën poeti këtë herë dhe si e ka përshkruar.

1. Mësuesi lexon në mënyrë shprehëse-emocionuese poezinë.
 2. Më pas lexojnë me radhë 3-4 nxënës vargjet e poezisë.
 3. Mësuesi pyet nxënësit nëse kanë fjalë të paqarta ose që nuk i kuptojnë. I shpjegon ato.
 4. Pyetje drejtuar nxënësve:
 - Ç’dukuri natyrore pikturon me fjalë poeti?
 - Çfarë përskuqi dielli? Gjeni fjalët në tekst.
 - Cilat janë fjalët që përsëriten? (e kuqe, gjak, skuq) Me cilën i lidhë këto fjalë poeti? Gjeni nga teksti fjalë të tjera që lidhen me ngjyrat e perëndimit (i zjarrtë, burbuqe)
 - Si e ka përftyruar poeti diellin:
 - a. siç është si yll, si dukuri natyrore
 - b. si një qenie e shpirtërizuar
- Gjeni nga teksti elementet që e argumentojnë atë.
- Me ç’ndjenja e ka përshkruar poeti këtë pamje? Ku duket?
-) habi
 -) dhimbje
 -) indiferencë
 -) admirim
 -) mospëlqim

-Cili është mesazhi i poezisë? Ku shfaqet ai më qartë në poezi?

-A e mendoni si është një perëndim dielli në vendet nordike apo atyre afër polit të veriut? Po në ekuator? Nga ndryshojnë? A ju pëlqen perëndimi ynë? Si ndiheni për këtë dhuratë të mrekullueshme të natyrës? Ne jemi vend mesdhetar dhe kemi një perëndim të bukur, plot jetë, që shumë të tjerë do të na kishin zili.

-Ç’lloj poezie është poezia “Pamje”? (poezi e peizazhit)

-Nga dallon *peizazhi si punë e një piktori nga peizazhi i një poezie*? Me se pikturon piktori? Po poeti?

-Cili poet tjetër shquhet për peizazhe artistike? (L. Poradeci) A mund të më thoni tituj ose vargje të poezisë së tij?

Informacioni shtesë: *Personifikimi*, figurë letrare që objekte dhe sende pa shpirt i shpirtërizon, u jep veçori, tipare të njerëzve.

Nëpërmjet projektorit shfaqen foto të piktorëve të njohur shqiptar dhe foto të tjera artificiale të shpirtërizimit të natyrës, marrë nga interneti. Nxënësit shikojnë dhe komentojnë fotot.

Hapi i katërt: *punë në grupe*

(15 min)

Grupi I: Jo më shumë se me 6 fjali kthejeni poezinë në prozë, duke iu përmbajtur përshkrimit dhe përfytyrimit të poetit .

Grupi II: Me ç’mjete artistike i ndërton përfytyrimet poeti? Gjeni, emërtoni figurat letrare tek poezia.

(informacion shtesë: similituda, krahasim i zgjeruar).

Grupi III: A është ndërtuar poezia në strofa? A është e njëjtë gjatësia e vargut? Gjeni fjalët që rimojnë. A i përkasin këto fjalë së njëjtës pjesë ligjërate?

Grupi IV: A mbaron mendimi brenda një vargu? Gjeni te poezia ku fillon dhe ku mbaron fjalia e parë që kumton një mendim të plotë? Ç’lloj fjalish është ajo duke u nisur nga ndërtimi? Ç’pozicion ka kryefjala: para apo pas kallëzuesit?

Grupi V: Përfytyroni, shpirtërizoni elemente të natyrës, me fjalë ose skica të shpejta, ashtu si ka vepruar poeti.

Diskutim i punëve të grupeve. Sqarime. Plotësime. Vlerësime

Detyrë shtëpie: Nëpërmjet shpirtërizimit dhe figurave letrare, ndërtoni artistikisht me fjalë ose me penel një peizazh artistik. Sqarime për detyrën.

2.3 Veprimtari Mësimore Nr. 3

(fragment)

Tema : Harri Poter (Xhoanë Rouling)

Rezultatet e pritshme:

Nxënësi:

- dëgjon me vëmendje tekstin e lexuar dhe bën pyetje rreth tij;
- krahason informacionet e marra nga teksti me informacionet e marra nga filmi me të njëjtin titull si tregimi;
- bashkëbisedon me nxënësit e tjerë për Harri Poterin dhe historitë e tij;
- tregon ngjarjet që ka parë në film dhe i krahason ato me ngjarjet në tregimin e dhënë;
- tregon ndryshimet (nëse ka) ndërmjet historisë në tekstin letrar dhe historisë së treguar në film;
- lexon tekstin letrar;
- kupton çfarë është shkruar dhe bën pyetje për atë që nuk e kupton;
- dallon elemente të formës dhe strukturës;
- jep mendimet e tij në lidhje me tregimin etj.;
- shkruan një histori imagjinare duke u bazuar në tekstin e dhënë;
- paraqet një variant tjetër për mbylljen e tregimit.

Koha e sugjeruar: dy orë mësimore

Fushat që integrohen: arte

Metodologjia: pema e mendimit, leximi i drejtuar, stuhi mendimi, kllaster, bashkëbisedim.

Burimet dhe mjetet:

- njohuritë dhe aftësitë paraprake të nxënësit;
- teksti mësimor;
- informacione nga interneti: foto, video;
- kompjuter, videoprojektor, DVD etj.

Zhvillimi i veprimtarisë mësimore

Hapi i parë: *Aktivizimi i njohurive të mëparshme.*

Mësuesi bën pyetje në lidhje me njohuritë që kanë nxënësit për filmat për fëmijë.

- A keni parë filma për fëmijë?
- Cilët filma keni parë?
- A ju kanë pëlqyer?
- Po personazhet e filmit ju kanë tërhequr?
- Cili personazh ju ka pëlqyer më shumë?
- E keni parë filmin me Harri Poterin?
- Si ju duket si personazh?
- Ma përshkruani me pak fjalë portretin e tij fizik.

- *Paraqitja e fotove dhe e pjesëve të filmit me anë të videoprojektorit.*



Të tjera imazhe mund të gjenden në web duke klikuar me togfjalëshin: Harry Potter - Imazhe

Mësuesi pyet nxënësit në lidhje me fotot e shfaqura në monitor.

Ai paraqet me anë të videoprojektorit një video në YouTube që përkon me pjesën letrare në tekst. Më poshtë paraqitet link-u ku nxënësit mund të shohin videon: www.youtube.com/watch?v=l3ygiGa5vFw

1. A përputhet portreti fizik që ju keni në imagjinatën tuaj me portretin në foto?
2. A e rikujtuat filmin duke e parë sërish ?
3. Po librin për historinë e Harri Poterit e keni lexuar?

- *Paraqitja e videove të tjera të filmit Harri Potter .*

Më poshtë paraqiten video të tjera të shkëputura nga filmi “Harri Potter”:

www.youtube.com/watch?v=zHPqO0UnaW8

www.youtube.com/watch?v=se-YgJOe0Gg

www.youtube.com/watch?v=EC2tmFVNNE

Nxënësit shikojnë videot e tjera të filmit. Këtë gjë e bëjnë për ta parë më të plotë personazhin e Harrit dhe për ta plotësuar më mirë figurën e tij dhe të personazheve të tjera.

Hapi i dytë: *Leximi i tekstit.*

Njëri nga nxënësit lexon tekstin e dhënë. Pas përfundimit të leximit, nxënësit diskutojnë për fjalët që nuk kuptojnë dhe për situata të ndryshme. Përkrahajnë personazhet e tregimit dhe japin mendimin e tyre se cili nga personazhet mund të cilësohet si personazh negativ dhe cili mund të cilësohet si personazh pozitiv. Diskutojnë në lidhje me idetë që marrin pasi lexuan tekstin, me gjuhën e përdorur në tekst, me figuracionin që është përdorur. Ata bëjnë një analizë gjuhësore dhe një analizë të personazheve të tekstit duke e ilustruar në çdo rast me shembuj.

Hapi i tretë: *Bashkëbisedimi me mësuesin për librat e tjerë për Harri Poterin.*

Mësuesi i pyet nxënësit nëse i kanë lexuar librat e tjerë për Harri Poterin dhe cili prej tyre u ka pëlqyer më shumë. Më pas ata japin mendimet e tyre në lidhje me personazhet që u kanë pëlqyer më shumë dhe personazhet që nuk u kanë pëlqyer shumë.

Në fletore listojnë emrat e personazheve duke i ndarë në disa grupe sipas skemës së mëposhtme:



Pasi i ndajnë personazhet në grupe sipas skemës së mësipërme, nxënësit i krahasojnë më njëra-tjetrën këto personazhe dhe gjejnë të përbashkëtat mes tyre.

Hapi i katërt: *Bashkëbisedimi i mësuesit dhe nxënësve në lidhje me mënyrat e komunikimit.*

Për të kuptuar sa më mirë mënyrat e komunikimit në tregim mësuesi u drejton disa pyetje nxënësve:

1. Si shprehen në tekst mënyrat e komunikimit mes Harrit dhe gjarprit?
 - a) me shikim;
 - b) me fjalë;
 - c) me gjeste;
 - d) me fërshëllimë?
2. Si është në tekst komunikimi mes Harrit dhe kushërinjve të tij?
 - a) i mirë;
 - b) i keq;
 - c) i ftohtë;
 - d) i dhunshëm?
3. Si komunikonte Harri me xhaxhanë e tij?

Nxënësit tregojnë me fakte nga teksti jetën e vështirë që bënte Harri në shtëpinë e xhaxhait.

- *Mendimet e nxënësve në lidhje me historitë e personazhit kryesor, Harri Poterit.*

Nxënësit japin mendimet e tyre në lidhje me këtë personazh. Ata gjithashtu futen në botën e këtij filmi, mendojnë sikur janë shoqëruar të Harri Poterit dhe tregojnë aventurat që ndjekin gjatë gjithë kohës (me imagjinatë).

Përshkruajnë udhëtimin imagjinar që bëjnë me të duke përdorur fjalë ose togfjalësha të botës imagjinare si p.sh.:

Makina fluturuese, rrugët me re, i frikshëm, askushi, ulëriti, dihati etj.

Hapi i pestë: *Shkrimi i një historie imagjinare nga secili nxënës duke përdorur fjalët kyçe që ndodhen në tekst.*

Nxënësit shkruajnë një histori ku përdorin fjalët kyçe që i kanë gjetur më parë në tekstin e dhënë.

Vlerësimi i veprimtarisë mësimore

Situata quhet e realizuar nëse pjesa më e madhe e nxënësve e ka kuptuar tekstin, u kanë dhënë përgjigje pyetjeve të mësipërme dhe kanë krijuar historitë e tyre imagjinare.

Jepet detyra e shtëpisë e cila mund të jetë njëra nga temat e mëposhtme:

1. Bëni një përshkrim të shkurtër të personazhit tuaj më të dashur.
2. Jepni një mbyllje tjetër për tregimin që lexuat.
3. Si do të veproni ju nëse do ishit në rolin e Harrit?

2.4 Veprimtari Mësimore Nr. 4

(fragment)

Nesër , pasqyrën e dëshirave do ta çojnë në një vend tjetër, Harri, dhe unë kërkoj prej teje të mos përpiqesh kurrë ta gjesh. Nëse do të qëllojë ta hasësh përsëri, do të jesh i përgatitur. Mos harro: nuk ka kuptim që njeriu të zhytet mes ëndrrave dhe të harrojë të jetojë. Dhe tashti, pse s'e hedh

krahëve atë mantel të hatashëm dhe të kthehesh në shtrat?....

(pjesë nga vëllimi “Harri Poter dhe guri filozofik”)

Tema : Pasqyra e dëshirave (Xhoana Rouling)

Rezultatet e pritshme

Nxënësi:

- dëgjon me vëmendje tekstin e lexuar dhe bën pyetje rreth tij;
- lexon tekstin;
- dallon elemente të formës dhe strukturës;
- jep mendimet e tij rreth fjalëve të veçuara të dy personazheve;
- jep mendimin e tij lidhur me pasqyrën si pasqyrë e realitetit dhe fantazisë duke e ilustruar me fjali nga teksti;
- dallon në dialogun e dy personazheve elementet që e bëjnë të ndryshëm nga dialogu i zakonshëm;
- përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, fjalorë, enciklopedi ose internet);
- i shfrytëzon ato për realizimin e temës/detyrës së dhënë;
- klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën;
- përdor krahasimin dhe kontrastin për të gjetur dallimet dhe ngjashmëritë kryesore midis dy e më shumë dukurive;
- përdor mediet digjitale dhe mjediset informative për të komunikuar dhe bashkëpunuar;
- analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë

elektronikisht.

Koha e sugjeruar: dy orë mësimore

Fushat që integrohen: Arte

Metodologjia: Aktivizimi i njohurive të mëparshme – Brainstorming, pema e mendimit, leximi i drejtuar, stuhi mendimi, pune ne grupe, bashkëbisedim.

Burimet dhe mjetet:

-njohuritë dhe aftësitë paraprake të nxënësit;

-teksti mësimor;

-informacione nga interneti: video;

-kompjuter, videoprojektor, DVD etj.

Zhvillimi i veprimtarisë

Hapi i parë: *Aktivizimi i njohurive të mëparshme – Brainstorming*

Nëpërmjet diagramës së Venit nxënësit nxjerrin dallimet dhe të përbashkëtat midis *përrallës* dhe *legendës*.

Duke u bazuar te njohuritë e mëparshme nga tema të ndryshme të zhvilluara në klasë dhe nga informacionet që kanë nga internet dhe televizioni ata bëjnë dallimet ndërmjet reales, imagjinares dhe fantastikes.

Secili nga nxënësit plotëson shokun ose e korrigjon atë duke argumentuar për përgjigjet e gabuara. (Vlerësimi i nxënësve nga nxënësit e tjerë)

Hapi i dytë: *Leximi i drejtuar.*

(1 orë)

Njëri nga nxënësit lexon tekstin e dhënë. Pas përfundimit të leximit, nxënësit diskutojnë për fjalët që nuk kuptojnë dhe për situata të ndryshme. Përshkruajnë personazhet e tregimit dhe japin mendimin e tyre për secilin personazh. Diskutojnë në lidhje me idetë që marrin pasi lexuan tekstin, me gjuhën e përdorur në tekst, me figuracionin që është përdorur. Ata bëjnë një analizë gjuhësore dhe një analizë të personazheve të tekstit duke e ilustruar në çdo rast me shembuj.

Hapi i tretë: *Bashkëbisedimi me mësuesin*

Pasi lexojnë tekstin, me ndihmën e mësuesit, ata nxjerrin tiparet e përrallës dhe legendës dhe të përbashkëtat e të veçantat e të dyjave.



Nxënësit shfaqin mendimet e tyre në lidhje me “pasqyrën e dëshirave”. Ata shtrojnë pyetjen nëse kjo pasqyrë ishte si te pasqyra e filmit “Borëbardha” apo jo.

Nëse nuk ishte si te filmi për fëmijë, ku ndryshonte ajo?

Nxënësit japin mendimet e tyre duke i argumentuar me njohuritë që kanë apo me pjesë nga filmi.

Për të qenë sa më të qartë, mësuesi ka sjellë në klasë me anë të internetit një pjesë nga filmi “Borëbardha” dhe e paraqet me një videoprojektor dhe me një laptop.

<https://www.youtube.com/watch?v=Tg-sHCVzX3Q> –min.9-10

Hapi i katërt: *Të kuptuarit e tekstit*

Pasi kanë bërë një lexim të detajuar të tekstit dhe kanë dhënë komentet e tyre, nxënësit u përgjigjen disa pyetjeve që mësuesi bën për të parë se sa mirë e kanë kuptuar tekstin ata:

- a- Çfarë nuk i shqitej Harrit nga mendja?
- b- Ku shkoi ai natën e tretë dhe për ç’qëllim?
- c- Pse pasqyra quhej Pasqyra e Dëshirave?
- d- Çfarë shikonin shumica e njerëzve në atë pasqyrë?
- e- Pse Harri u çudit nga përgjigja e Urtimorit?

Nxënësit shprehin lirshëm mendimet e tyre dhe mësuesi në bashkëpunim me nxënësit vlerëson përgjigjet e dhëna.

Mësuesi kërkon nga nxënësit që të japin me shkrim mendimin e tyre rreth fjalëve të veçuara të dy personazheve.

Harri: Ne shohim atë që dëshirojmë...?

Urtimori: njeriu më i lumtur i kësaj bote do ta përdorte Pasqyrën e Dëshirave si një pasqyrë të zakonshme, domethënë që, duke u parë në të, do ta shihte veten bash ashtu siç është.

Hapi i pestë: Punë me grupe

Nxënësit ndahen në 4 grupe dhe secili grup gjen në tekst:

- a- Pyetjet dhe përgjigjet
- b- Arsyetimet
- c- Gjykimet personale
- d- Porositë

Po këto grupe gjejnë edhe:

- a- Sendet magjike
- b- Veprimet fantastike
- c- Personazhet fantastike
- d- Personazhet reale.

Vlerësimi i veprimtarisë mësimore

Mësuesi bën vlerësimet për nxënësit që kanë dhënë përgjigjet më të mira dhe i motivon nxënësit e tjerë për t'u përmirësuar.

Situata quhet e realizuar nëse pjesa më e madhe e nxënësve e kanë kuptuar tekstin, u kanë dhënë përgjigje pyetjeve të mësipërme dhe kanë argumentuar secilën nga përgjigjet.

Kjo temë mund të zhvillohet 2 orë.

Jepet detyra e shtëpisë: “Imagjinojeni veten të ulur para Pasqyrës së Dëshirave. Çfarë dëshirash do të kërkonit që të plotësoheshin si do e shikonit veten në këtë pasqyrë?”

2.5 Veprimtari Mësimore Nr. 5

Faik Konica “Bora”

(prozë poetike)

Kthjelltësia e qiellit shkoi me diellin, me lulet, me verën. Vjeshta e trishtueshme erdhi e iku. Tani po hyn dimri, edhe qiellin e kanë mbuluar re të qeta e të ftohta. Edhe sot, për të parën herë, zuri të bjerë bora...

Prapa qelqeve të dritares, po shikoj. Ngadalë-ngadalë, sikur ka frikë të dëgjohet, bora fluturon flokë-flokë e shtrohet mbi dhe. Bie kudo e duket se kërkon të ndreqë e të zbukurojë. Dy çupa të vockla shkojnë, e në leshrat e arta të tyre, të lëshuara mbi shpatullat, bora shkruan trëndafila të argjendtë. Djemtë qeshin, hidhen, lozin e luftojnë me topa. Zogjtë vërtiten rreth e rrotull pragjeve ciu-ciu për një thërrime buke! Si në verë, gjithë bota janë veshur në të bardha. Flokë-flokë, ngadalë, po bie bora...

Rezultatet e pritshme:

Nxënësi:

- shpreh përshtypjet e tij në lidhje me tekstin;
- dallon fjalët dhe shprehjet që përdor autori për të përshkruar stinën e vjeshtës dhe të dimrit;
- analizon mjetet artistike që përdoren në tekst dhe përcakton funksionin e tyre;
- përcakton tiparet e prozës poetike;
- krahason prozën poetike me tregimin ose poezinë;
- shpreh ndikimin që kanë stinët në botën e tij shpirtërore.

Koha e sugjeruar: dy orë mësimore

Fusha që integrohen: Gjeografi dhe arte

Metodologjia: stuhi mendimi, kllaster, bashkëbisedim, punë në grupe.

Materiale të nevojshme: projektor, teksti i nxënësit, foto të ndryshme etj.


Zhvillimi i veprimtarisë

Hapi i parë: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Bashkëbisedim me nxënësit:

- Cila stinë ju pëlqen më shumë? Pse?
- Po dimri ju pëlqen? Bora? Pse?
- Cila është atmosfera që krijohet kur bie borë?
- A ka ndodhur që të bjerë borë, kur keni qenë në Shqipëri ose në Kosovë? Ju pëlqen stina e dimrit atje?

Mësuesja krijon një kllaster për borën me përgjigjet e nxënësve



Hapi i dytë: Ndërtimi i njohurive të reja

Zhvillimi i imagjinatës së nxënësve

Nxënësit dëgjojnë muzikën e Vivaldit (vjeshta dhe dimri) dhe, ndërkohë, shohin peizazhe dimri nga vise të ndryshme shqiptare (Korçë, Tropojë, Prishtinë etj.).

Stuhi mendimi

Për stinët dhe bukuritë e tyre kanë shkruar shumë shkrimtarë shqiptarë (Naim Frashëri, Poradeci, Asdreni etj.). Një krijim të tillë ka shkruar edhe Faik Konica

- Çfarë dini për këtë autor?
- Keni lexuar më parë krijime të Faik Konicës?

Jeta dhe vepra e Faik Konicës

Mësuesi prezanton shkurtimisht disa të dhëna për jetën dhe veprën e autorit.

Faik Konica u lind në 1875 në Konicë dhe vdiq më 1942 në Uashington. Konica ishte “njeri me kulturë të lartë” (Noli), “enciklopedi shëtitëse” (G. Apolineri), eseist i shkëlqyer, politikan me orientim perëndimor, njohës i shumë gjuhëve të huaja, shkrimtar etj.

Veprat kryesore të Faik Konicës

- Doktor Gjilpëra zbulon rrënjët e dramës së Mamurrasit (roman i pambaruar)
- Ç’është liria
- Shqipëria si mu duk

Prezantimi i prozës poetike “Bora” të Faik Konicës.

Mësuesi lexon tekstin dhe u kërkon nxënësve që ndërkohë nxënësit të imagjinojnë borën që po bie. Më pas mësuesi kërkon përshtypjet e tyre për pjesën.

Të kuptuarit e tekstit

- Në cilën stinë jemi? Ku duket kjo? (dimër, në tri fjalitë e para)
- Pse Konica thotë që vjeshta është e trishtueshme? (bie shi, qielli është i zymtë, nuk ka më shumë lule, moti ftohet, bien gjethet e pemëve, ikin zogjtë etj.)
- Po ju si ndiheni gjatë stinës së vjeshtës? Çfarë ju pëlqen dhe çfarë nuk ju pëlqen?
- Po dimrin si përshkruhet? (qiellin e kanë mbuluar re të qeta e të ftohta, bie borë).
- Ku ndodhet autori? (në dritare)
- Si përshkruhet bora nga autori? Cila është atmosfera që krijon ajo në natyrë, te njerëzit, te zogjtë?
- Cilat janë ngjyrat me të cilat e përshkruan Konica dimrin? (e bardha dhe grija).

Mësuesja bën një kllaster (mund të përdorë format e flokëve të dëborës për kllasterin)



Më pas nxënësit krahasojnë kllasterin që plotësuan në fillim të veprimtarisë mësimore dhe shohin të përbashkët dhe dallimet mes tyre dhe autorit.

Interpretimi dhe vlerësimi i tekstit

Bashkëbisedim

- Ç'vlerë i japin fëmijët dhe zogjtë këtij teksti? (e plotësojnë kuadrin e dimrit, i japin tinguj dhe ngjyra të tjera, optimizëm etj.)
- Pse autori e nis me vjeshtën dhe e përfundon me verën? (bën krahasimet mes stinëve, tregon që çdo stinë ka të veçantën e saj etj.)
- A është në kontrast vera dhe dimri në këtë prozë poetike? Jepni një shembull. (kthjelltësia e qiellit- qielli i mbuluar me re)

Tiparet e prozës poetike

Mësuesi pyet:

- Çfarë është ky tekst? Poezi apo tregim?

Është shkruar në prozë, por nuk është tregim se nuk ka ngjarje (që ka një hyrje, një zhvillim dhe një mbyllje). Përshkruan ndjenjat dhe përjetimet e autorit, por nuk është poezi se nuk është

shkruar në vargje. Pra, ka edhe tiparet e një tregimi edhe të një poezie (po nuk është asnjëra nga këto). Mësuesi jep përkufizimin e prozës poetike. Ai, gjithashtu, mund t’i informojë që në letërsinë shqipe, proza poetike ka shkruar Migjeni, Lumo Skëndo etj.

Bazuar te ky tekst, nxënësit plotësojnë në një tabelë tiparet e prozës poetike, krahasuar me poezinë dhe tregimin.

Proza poetike	Poezia	Tregimi
Nuk ka ngjarje.	Nuk ka ngjarje.	Ka ngjarje.
Është e shkurtër.	Është e shkurtër.	Është më i gjatë se proza poetike dhe poezia.
Përshkruhen ndjenja, emocione etj.	Përshkruhen ndjenja, emocione etj.	Përshkruhen ndjenja, emocione etj., dhe rrëfëhet.
Është e shkruar në prozë.	Është e shkruar në vargje.	Është i shkruar në prozë.

Gjuha dhe stili

Figuracioni letrar

Epitetet që tregojnë ardhjen e dimrit- të qeta, të ftohta, të argjendtë etj.

Mësuesi sqaron nxënësit për krahasimin dhe metaforë dhe për funksionin e tyre. Ai jep shembuj që nxënësit t’i kuptojnë figurat letrare.

Më pas nxënësit gjejnë shembuj metaforash në prozën poetike si p.sh., vjeshta erdhi e iku, hyn dimri, bora fluturon, bora shkruan trëndafila etj.

Antiteza – erdhi dhe iku etj.

Punë me fjalorin

a) Mësuesi pyet nxënësit për kuptimin e fjalës *vesh*.

- *vë një petk në trup, fut krahët, këmbët e shtatin në një rrobë të qepur dhe mbështillem a mbulohem me të, i vë dikujt në trup petkat e tij.*

Më pas mësuesi kërkon që të gjejnë se ku është përdorur në tekst kjo folje (gjithë bota janë veshur me të bardha). Cili është kuptimi i kësaj foljeje këtu?

E mbulon ose e mbështjell me një shtresë bore dhe nuk lë të duket çfarë është nën të.

Mësuesi sqaron se këtu folja *vesh* nuk është përdorur për frymorët, por për borën.

b) Plotësoni në një tabelë emrat, mbiemrat dhe foljet që përdoren në njërin nga paragrafët e prozës poetike. P.sh.:

Emra	Mbiemra	Folje
Kthjelltësia	E trishtueshme	erdhi
Qiell	Të qeta	iku
Diell	Të ftohta	hyn
Lule		Kanë mbuluar
Vera		Zuri të bjerë
Vjeshta		

Hapi i tretë: Prezantimi i rezultateve të arritura

Nxënësit mund të zgjedhin mes dy kërkesave:

- Përpiquni bëni një pikturë sipas përshkrimit të Konicës.
- Përshkruani ndjenjat dhe emocionet që keni përjetuar kur ka rënë borë.

Nxënësit prezantojnë punët e tyre dhe vlerësojnë njëri-tjetrin.

Hapi i katërt: Konkluzionet e kësaj veprimtarie mësimore

2.6 Veprimtari Mësimore Nr. 6

Koli Xoxe “Shqipëria dhe Shqiptarët”

(tekst joletrar)

Ndërmjet Adriatikut, Pindit, vargmaleve ballkanike, alpeve Dinarike, në vijën që ndan lindjen nga perëndimi, ku historia ka përndeshjet e kaq shumë popujve nomadë dhe lindjen e shumë qytetërimeve të reja, aty, si një fortifikatë natyrore e fuqishme shtrihet Shqipëria. E mbrojtur nga pushtimet e huaja në të tria anët e veta nga male të larta dhe nga e ana e katërt prej detit, Shqipëria ishte e banuar fillimisht nga një racë, origjina e së cilës zë fill që në kohë të pellazgëve. Ndonëse jo e huaj ndaj qytetërimit grek, kjo racë ruajti karakterin dhe krenarinë e saj për origjinën parahelenike. Në shekullin II para Krishtit, vendi u bë strehë për të gjitha tributë maqedonase dhe epirote të cilat, për t'u mbrojtur nga pushtimet romake, ia mbathën me ardhjen e legjioneve të Paul-Emilit.

Duke parë nga jashtë, territori shqiptar duket, në njëfarë mënyre, si i padepërtueshëm por, sapo hyn brenda, vë re vende dhe peizazhe të një bukurie dhe hiri të jashtëzakonshëm. Ndërmjet dy vargmalesh të thepisura e të zhveshura, që nga jashtë duken si pak tërheqëse, shtrihen lugina të hirshme dhe fusha të gjera të begatshme. Prapa brezit shkëmbor dhe të thepisur, shtrihen fusha të gjera dhe pyje të gjelbra ose bojë ari, sipas stinëve. Në anët e grykave të frikshme dhe të vargjeve të ngjeshura të maleve, ndeshesh befasisht me oaze të bukura, të veshura me bimësi të harlisur. Përrenj bubullitës rrjedhin furishëm nga malet e thikta dhe shndërrohen më poshtë në rrëkera të kristalta e të qeta, që gjarpërojnë nëpër lugina të parfumuara, ku

ngrihen pemë të shumta, gjithmonë të gjelbërta dhe shkurre e kaçube të shpërndara në relievin ngjyrë smeraldi. Gjatë bregdetit, plazhe të kaltërta dhe të qeta, si edhe gjire të thella, vizatohen nën këmbët e maleve, majat e të cilave janë të zhytura përjetësisht në retë që i shtyn era. Kështu është vendi ku për shekuj kanë banuar shqiptarët "bijtë e shqipes".

Duke pasur një lloj izolimi ata ishin quajtur, në mënyrë të përgjithshme, si maqedonë apo ilirianë, sipas tekave të pushtesve të ndryshëm. Por ata, krejtësisht indiferentë e mospërfillës ndaj nofkave që u ngjisin, të cilat nuk ndikonin aspak mbi racën e tyre, mbi gjuhën apo mbi karakterin kombëtar, duket se nuk preokupoheshin për rëniet e perandorive ose për ndryshimet e kufijve. Gjithmonë krenarë ata ruajtën pavarësinë e tyre, nga e cila asnjë fuqi nuk mund t'i privonte.

Rezultatet e pritshme:

Nxënësi:

- tregon brendinë duke e konkretizuar me ilustrime dhe shembuj nga teksti;
- shpreh lidhjen e tij shpirtërore me Shqipërinë dhe shqiptarët;
- analizon tekstin dhe përcakton qëllimin e tij;
- vlerëson lashtësinë historike dhe bukuritë gjeografike të Shqipërisë;
- dallon mjetet artistike që përdoren në tekst dhe përcakton funksionin e tyre.

Koha e sugjeruar: 2 orë mësimore

Fusha që integrohen: Histori dhe gjeografi

Metodologjia: stuhi mendimi, kllaster, bashkëbisedim, punë në grupe.

Materiale të nevojshme: projektor, foto të ndryshme, materiale informuese nga interneti etj.

Zhvillimi i veprimtarisë

Hapi i parë: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Bashkëbisedim me nxënësit:

- Çfarë dini për Shqipërinë? Ku ndodhet ajo? Po për historinë e saj?
- A është e bukur Shqipëria?
- Çfarë ju ka pëlqyer më shumë kur e keni vizituar?

Hapi i dytë: Ndërtimi i njohurive të reja

Zhvillimi i imagjinatës së nxënësve

Mësuesi përzgjedh që t'ju prezantojë nxënësve pjesë nga ndonjë dokumentar për bukuritë natyrore dhe historinë e Shqipërisë. Sugjerohet që dokumentari të jetë prodhim i medieve të huaja.

Lexim shprehës i tekstit

Mësuesi lexon me zë tekstin, ndërkohë qau kërkon nxënësve t'i imagjinojnë viset që përshkruhen në tekst.

Fjalët e reja

Sqarohen kuptimet e fjalëve të reja dhe nxënësit formojnë fjali me to.

Të kuptuarit e tekstit

- Cili është qëllimi i autorit në këtë tekst? (Përshkrimi i bukurive natyrore, si dhe i lashtësisë dhe i krenarisë së shqiptarëve)
- Ku ndodhet Shqipëria sipas autorit?
- Si i përshkruan autori bukuritë natyrore të Shqipërisë?
- Si iu bënë ballë shqiptarët pushtuesve të ndryshëm? Ç'vlera të tyre shfaqen në këtë qëndresë?
- Cili është titulli më i përshtatshëm që mund t'i vini secilit paragraf? (p.sh., paragrafi i fundit: *Shqiptarët ruajtën të paprekur identitetin e tyre kombëtar.*)
- Gjeni në tekst detaje që dëshmojnë se Shqipëria, megjithëse një vend me natyrë të ashpër, fsheh në vetvete bukuri të rralla.

(Ndërmjet dy vargmalesh të thepisura e të zhveshura, që nga jashtë duken si pak tërheqëse, shtrihen lugina të hirshme dhe fusha të gjera të begatshme.

Prapa brezit shkëmbor dhe të thepisur, shtrihen fusha të gjera dhe pyje të gjelbra ose bojë ari, sipas stinëve.

Në anët e grykave të frikshme dhe të vargjeve të ngjeshura të maleve, ndeshesh befas me oaze të bukura, të veshura me bimësi të harlisur.

Përrenj bubullitës rrjedhin furishëm nga malet e thikta dhe shndërrohen më poshtë në rrëkera të kristalta e të qeta, që gjarpërojnë nëpër lugina të parfumuara, ku ngrihen pemë të shumta, gjithmonë të gjelbërta dhe shkurre e kaçube të shpërndara në relievin ngjyrë smeraldi.) etj.

Gjuha dhe stili

- Cila klasë fjalësh mbizotëron në tekst? (mbiemrat). Pse? (sepse teksti përshkruan bukuritë natyrore të Shqipërisë dhe në përshkrime përdoren kryesisht mbiemrat). Nënvizoni disa prej tyre.
- Cili është sinonimi i fjalës e thikta në grupin emëror malet e thikta? (të thepisura, të mprehta etj.).
- Si është formuar fjala pushtimet? (emër prejfoljor, me prapashtesën im pushto+ im).

Hapi i tretë: Prezantimi i rezultateve të arritura

Reflektime rreth tekstit

- A ju pëlqeu ky tekst? Çfarë ju pëlqeu më shumë? Pse?
- Si e gjykoni përshkrimin e autorit? (objektiv apo subjektiv) Pse?

Detyrë me shkrim

Mësuesi ndan në grupe nxënësit dhe kërkon nga ata që të shtojnë të dhëna të tjera për gjeografinë ose historinë e viseve shqiptare.

Nxënësit prezantojnë punët e tyre.

Detyrë shtëpie

Sillni në klasë foto të ndryshme që konkretizojnë përshkrimet e bukurive natyrore të këtij teksti dhe diskutoni rreth tyre

Hapi i katërt: Konkluzionet e kësaj veprimtarie mësimore

2.7 Veprimtari Mësimore Nr. 7

Ali Podrimja “Me Jetue”

(poezi)

Tim bir, Lumit

Erdhe në jetë

Nuk ka më nevojë për kuje, lutje

Kryesorja të jetosh

Këtë gur ta hedhësh më larg se Unë

Prandaj:

Bukën ta pjekësh dy herë nën saç

Ujin ta ziesh deri në shkallën 99

Derisa të mbetesh ti i vetmi kërthi në ajër

në kohë kozmos.

Rezultatet e pritshme:

Nxënësi:

- veçon momentet kryesore të jetës dhe veprës së Ali Podrimjes;
- lexon rrjedhshëm dhe në mënyrë shprehëse poezinë;
- shpjegon kuptimin e figurshëm të porosive që jep poeti nëpërmjet vargjeve;
- dallon rendin e fjalëve në vargje dhe tregon funksionin e tij në poezi;
- analizon disa veçori të gjuhës së poetit;
- dallon mesazhin që përcjell poezia;
- vlerëson kontributin, përkushtimin dhe këshillat e prindit të tij.

Koha e sugjeruar: 1 orë mësimore

Fusha që integrohen: Histori

Metodologjia: shkrim i lirë, bashkëbisedim, ditari 2-pjesësh, punë në grupe.

Materiale të nevojshme: fletë pune, foto të ndryshme, një glob etj.

Zhvillimi i veprimtarisë

Hapi i parë: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Globi i këshillave

Mësuesi improvizon një kuti në formë globi dhe u thotë nxënësve:

- Kujtoni një këshillë të vlefshme që iu kanë dhënë prindërit, shkruajeni në një fletë dhe vendoseni atë në glob.

Nxënësit vendosin në glob fletët e tyre.

Hapi i dytë: Ndërtimi i njohurive të reja

Prezantim i përgjithshëm për jetën dhe krijimtarinë e poetit

Mësuesi prezanton titullin e poezisë, autorin e saj, si dhe jep disa të dhëna për jetën dhe veprën e Ali Podrimjes. Mësuesi sqaron se kujt i kushtohet kjo poezi, si dhe rrethanat familjare të poetit. Përmendet fakti se poezia është shkruar, kur poeti e dinte se të birit i kishte mbetur edhe pak jetë, për shkak të sëmundjes së pashërueshme.

Ali Podrimja u lind më 28 gusht, 1942 në Gjakovë (Kosovë), në kohë lufte dhe pati një fëmijëri mjaft të vështirë. Ali Podrimja është autor i më shumë se dhjetë vëllimeve me poezi dhe mbahet sot nga kritika si përfaqësuesi më tipik i poezisë së sotme shqiptare dhe si një poet me emër dhe në nivel ndërkombëtar. Podrimja vdiq në vitin 2012, pas një festivali të poezisë në Francë.

Veprat e tij kryesore janë:

- Zari
- Thirrje
- Buzëqeshje në kafaz
- Harakiri
- Burgu i hapur
- Lum Lumi

Lexim shprehës i poezisë

Mësuesi dhe një nxënës lexojnë në mënyrë shprehëse poezinë. Nxënësit e tjerë dëgjojnë ose lexojnë në heshtje poezinë.

Të kuptuarit e tekstit

- Pse poeti e titullon poezi “Me jetue”? (sepse e gjithë poezia është ndërtuar në formën e këshillave që poeti i jep djalit të tij: Çfarë duhet bërë që të jetosh (me jetue- në dialektin e gegërishtes)
- Si e kuptoni vargun: “Nuk ka nevojë për kuje e lutje”?
- Cilat janë këshillat e poetit për të birin? Si i kuptoni ju këto këshilla?

Përgjigjet e kësaj pyetjeje jepen në trajtën e një ditari dypjesësh. Në njërën anë të fletës nxënësit shënojnë këshillat e poetit për të birin, Lumin, ndërsa në anën tjetër shpjegimin e tyre për këto këshilla. P.sh.:

Porositë e poetit	Shpjegimi
Nuk ka nevojë për kuje, lutje.	Në jetë nuk është e nevojshme të qash e të lutesh.
Këtë gur ta hedhësh më lart se unë.	Guri është përpjekja dhe arritjet që realizon njeriu në jetë. Poeti e këshillon të birin që t’i tejkalojë arritjet e të atit.
Bukën ta pjekësh dy herë nën saç	Njeriu duhet të ketë durim në jetë.
Ujin ta ziesh deri në shkallën 99.	...

Nxënësit në këtë rast punojnë në dyshe. Pas plotësimit të ditarit 2-pjesësh, nxënësit lexojnë shpjegimet e tyre. Ata, gjithashtu, krahasojnë mënyrën se si i kanë kuptuar këshillat e poetit.

Mesazhi i poezisë

- Cili është mesazhi i kësaj poezie?

Mesazhi: *E ardhmja e një kombi varet nga brezi i ri që ai edukon.*

Vargjet kur del qartë ky mesazh janë: *Kryesorja të jetosh/ këtë gur ta hedhësh më lart se Unë.*

Gjuha dhe stili

Rendi i fjalëve në poezi

Nxënësit lexojnë pyetjen dhe i rikthehen poezisë për të nënvizuar rastet kur rendi te fjalët këshilluese prishet. Pasi i nënvizojnë, nxënësit i lexojnë ato. P.sh.:

- Këtë gur ta hedhësh më larg se unë.
- Bukën ta pjekësh dy herë nën saç.
- Ujin ta ziesh deri në shkallën 99.

Nxënësit japin mendimet e tyre në lidhje me këtë zgjedhje të poetit. P.sh., duke prishur rendin dhe duke mos e nisur me folje, vargjet nuk marrin trajtën e urdhrave, por të këshillave, vihet theksi te fjalët e para etj.

Hapi i tretë: Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Këshillat e prindërve

Nxënësit kanë hedhur në glob dëshirat e prindërve. Mësuesi ose ndonjë nxënës i lexojnë një nga një të gjitha këshillat. Nxënësit shohin edhe pikat e takimit mes poetit dhe prindërve të tyre në klasë. Mësuesi u kujton nxënësve që prindërit janë njerëzit që na duan më shumë në këtë botë, ndaj duhet t'i dëgjojnë dhe t'i zbatojmë këshillat e tyre.

Shkrim i lirë

Nxënësit shkruajnë një krijim të shkurtër me temë “Këshillat e prindit tim janë mjaft të vlefshme për mua”. Nxënësit prezantojnë krijimet e tyre dhe vlerësojnë njëri-tjetrin.

Hapi i katërt: Konkluzionet e kësaj veprimtarie mësimore

2.8 Veprimtari Mësimore Nr. 8

Ismail Kadare “Kronikë në Gur”

(fragment nga romani)

Ky ishte një qytet i çuditshëm, që dukej sikur kishte dalë në luginë papritur një natë dimri si një qenie prehistorike dhe, duke u kacavjerrur me mundime të mëdha, i ishte qepur faqes së malit. Gjithçka në këtë qytet ishte e vjetër dhe e gurtë, duke filluar që nga rrugët dhe çezmat e gjer te çatitë e shtëpive të tij të mëdha, shekullore, që ishin të mbuluara me pllaka guri ngjyrë gri, të cilat u ngjanin luspave gjigande. Ishte e vështirë të besoje se nën ato korraca të forta gjëllonte mishi i butë i jetës.

Çdo udhëtari, që e shikonte për herë të parë, qyteti i zgjonte dëshirën për të bërë një krahasim, por menjëherë pasi udhëtari binte në grackë, qyteti e flakte krahasimin, sepse ky ishte një qytet që nuk ngjante me asgjë. Ai nuk i mbante gjatë krahasimet, ashtu siç nuk mbante gjatë shirat, breshërin, ylberet dhe flamurët e shumëngjyrshëm të huaj që iknin siç vinin mbi çatitë e tij, aq të përkohshëm e irealë sa ç'ishte i përjetshëm dhe konkret.

Ky ishte një qytet i pjerrët, ndoshta më i pjerrëti në botë, që i kishte thyer të gjitha ligjet e arkitekturës dhe të urbanistikës. Nga shkaku i pjerrësisë së madhe ndodhte që në nivelin e çatisë së njëres shtëpi gjendeshin themelet e tjetrës dhe me siguri ky ishte i vetmi vend në botë ku njeriu, po të rrëzohej në anë të rrugës, në vend që të binte në hendek, mund të binte mbi

çatinë e ndonjë shtëpie të lartë. Këtë gjë më mirë se kushdo e dinin pijanecët. Ishte me të vërtetë një qytet shumë i çuditshëm. Ti mund të ecje rrugës dhe po të doje, mund të zgjatje pak krahun dhe të vije kapelën tënde mbi majën e një minareje. Shumë gjëra këtu ishin të pabesueshme dhe shumë gjëra ishin si në ëndrra.

Duke ruajtur me vështirësi jetën njerëzore në gjymtyrët dhe nën lëvozhgën e tij të gurtë, qyteti i shkaktonte asaj pa dashur shumë dhembje, gërvishtje dhe plagë, dhe kjo ishte një gjë e natyrshme, përderisa ky ishte një qytet prej guri dhe çdo prekje e tij ishte e ashpër dhe e ftohtë.

Ishte e vështirë të ishe fëmijë në këtë qytet.

Rezultatet e pritshme:

Nxënësi:

- veçon momentet kryesore të jetës dhe veprës së Ismail Kadaresë;
- tregon me fjalët e tij brendinë e tekstit;
- analizon tiparet me të cilat autori e ka veshur qytetin e tij të lindjes;
- pasuron fjalorin me fjalë të reja dhe i përdor ato në fjali;
- gjykon për vlerat gjuhësore të veprës së Kadaresë;
- vlerëson kontributin e Kadaresë në letërsinë shqipe.

Koha e sugjeruar: 2 orë mësimore

Fusha që integrohen: Histori dhe gjeografi

Metodologjia: bashkëbisedim, stuhi mendimi, punë në grupe.

Materiale të nevojshme: projektor, fletë pune, foto të ndryshme, materiale informuese nga interneti.

Zhvillimi i veprimtarisë

Hapi i parë: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Stuhi mendimi

- Çfarë dini për qytetin e Gjirokastrës?
- Ku ndodhet ky qytet?
- Njihni ndonjë figurë të njohur që ka lindur në Gjirokastrë?

Hapi i dytë: Ndërtimi i njohurive të reja

Prezantim i përgjithshëm për jetën dhe krijimtarinë e poetit


Mësuesi prezanton titullin e romanit nga është shkëputur fragmenti i mësipërm, autorin e saj, si dhe jep disa të dhëna për jetën dhe veprën e Ismail Kadaresë. Mësuesi, gjithashtu, ndalet te subjekti i romanit “Kronikë në gur”.



- Lindi në qytetin e Gjirokastrës, në vitin 1936.
- Shkollën e mesme e kreu në gjimnazin “Asim Zeneli”.
- Më pas kreu studimet e larta në Fakultetin e Historisë e të Filologjisë në Universitetin e Tiranës, pastaj në Institutin “Gorki” të Letërsisë Botërore në Moskë.
- Në fund të vitit 1990, Kadare u largua së bashku me familjen në Paris, por mban lidhje mjaft të ngushta me Shqipërinë.



- Ismail Kadare është autor i shumë veprave në poezi e prozë.
Frymëzime djaloshare, Ëndërrimet, Shekulli im.
Gjenerali i ushtrisë së vdekur, Kronikë në gur, Dimri i madh, Përbindëshi, Viti i mbrapshtë etj.



- Ismail Kadare është një nga personalitetet më të shquara të kulturës shqiptare, ambasador i saj në botë. Ai ka marrë shumë çmime kombëtare, është kandidat i çmimit "Nobel" për shumë vite me radhë, anëtar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Anëtar i Akademisë Franceze të Shkencave Morale etj.

Lexim shprehës i fragmentit

Mësuesi lexon në mënyrë shprehëse fragmentin. Leximin e shoqëron me pamje ose foto të ndryshme nga qyteti i Gjirokastrës. Fotot konkretizojnë imazhet sureale që krijohen nga leximi i fragmentit

Fjalët e reja

Mësuesi punon me nxënësit fjalët e reja dhe u kërkon atyre që t'i përdorin këto fjalë në fjali.

Të kuptuarit e tekstit

- Çfarë të veçantash kishte ky qytet? Çfarë ju bëri përshtypje më shumë?
- Pse Kadare e ka titulluar këtë roman “Kronikë në gur”? Si mendoni ju?
- Cila është pjesa që ju pëlqen më shumë në fragmentin e mësipërm dhe pse?
- Si e kuptoni krahasimin e përdorur në këtë fjali “Ky ishte një qytet i çuditshëm, që dukej sikur kishte dalë në luginë papritur një natë dimri si një qenie prehistorike dhe, duke u kacavjerur me mundime të mëdha, i ishte qepur faqes së malit.”? Pse e krahason me një qenie historike? (sepse qyteti ishte e lashtë etj.).
- Në cilin paragraf shkrimtari ndalet të arkitektura e çuditshme e qytetit? Çfarë ju bën përshtypje aty? (paragrafi i tretë)

- A ngjan përshkrimi i qytetit në këtë fragment me fotot që patë? Çfarë ngjashmëri vutë re?
- Nëse nuk do t'i kishit parë fotot, çfarë do të mendonit për këtë përshkrim? (ngjan me një përshkrim të realizmit magjik ose duket krijim i fantazisë së autorit etj.).
- Si e kuptoni shprehjen *mishi i butë i jetës*? Me kë është në kontrast kjo shprehje? (me qytetin, me normat dhe rregullat e tij etj.)
- Cili ishte qëndrimi që mbante qyteti ndaj pushtuesit të huaj? Ku duket kjo në fragment? (*Ai nuk i mbante gjatë krahasimet, ashtu siç nuk mbante gjatë shirat, breshërin, ylberet dhe flamurët e shumëngjyrshëm të huaj që ikin siç vinin mbi çatitë e tij*)
- Pse Kadare shprehet që “*Duke ruajtur me vështirësi jetën njerëzore në gjymtyrët dhe nën lëvozhgën e tij të gurtë, qyteti i shkaktonte asaj pa dashur shumë dhembje, gërvishtje dhe plagë*”? (rregullat dhe normat e ngurta të qytetit janë në konflikt me të renë dhe njerëzoren)
- Pse shkrimtari mendon që ishte e vështirë të ishte fëmijë në këtë qytet? Po ju a do të kishit dëshirë të jetonit aty? Pse?
- Si do të ishte fëmijëria juaj në këtë qytet? Si e imagjinoni?

Gjuha dhe stili

- Gjeni disa mbiemra që janë përdorur në fragment? Çfarë funksioni kanë ato?
- Në cilën kohë rrëfëhet në fragment? (kohën e pakryer) Ç'funksion ka ky përdorim? (krijon idenë e lashtësisë)
-

Hapi i tretë: Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Shkrim i lirë

Imagjinoni një ngjarje në të cilën personazh kryesor të jetë një fëmijë në qytetin e gurtë. Nxënësit prezantojnë shkrimet e tyre dhe komentojnë dhe vlerësojnë njëri-tjetrin.

Më shumë për Kadarenë

Mësuesi udhëzon nxënësit të lexojnë diçka nga krijimtaria e Ismail Kadaresë (Kronikë në gur; Gjenerali i ushtrisë së vdekur; Nën punësi i pallatit të ëndrrave; Kështjella; Përbindëshi; Darka e gabuar; Gjakftohtësia; Dimri i madh; Poezi etj.). Nxënësit prezantojnë përshtypjet dhe gjykimet e tyre për veprën e Kadaresë. Mësuesi vlerëson kontributet e nxënësve në këtë veprimtari.

Më shumë për Gjirokastrën

Mësuesi ndan nxënësit në grupe. Secili grup mbledh informacione nga fusha të ndryshme për Gjirokastrën (historinë, pozitën gjeografike, festivalin folklorik, pasurinë kulturore, folklorin, gatimet, figurat e shquara të këtij qyteti etj.). Nxënësit prezantojnë punët e tyre dhe vlerësojnë punët e njëri-tjetrit.

Hapi i katërt: Konkluzionet e kësaj veprimtarie mësimore

2.9 Veprimtari Mësimore Nr. 9

Naim Frashëri “Atdheu”

(poezi)

*O Atdhe! Më je i dashur sa më s'ka
Më je nënë, më je motër, më je vëlla.
Nga ç'ka rrotull më i shtrenjti ti më je,
je më i miri nga çdo gjë që ka ky dhé.
Ty përditë të pat parë ime nënë,
dheu yt në fund atë e pati ngrënë.
Numëruar t'i pat lulet syri i saj,
te ti lindi, te ti vdiq ajo pastaj.
Ti i ke parë gjysh stërgjyshërit e mi,
edhe eshtrat tretur ua ke po ti.
Nga ti, o shpirt kurrë s'qenë ndarë,
pranë teje patën qeshur, patën qarë.
Nëna ime vdiq, ndaj ty të kam sot nënë,
nënë që s'ke vdeqje kurrë, faqehënë.
...
Begatoje, o Zot, ti këtë vend!
Epu njerëzve të tij ti mbroth e shend!
Hi u bëfshin gjithmonë armiqtë e tij!
Gaz përjetë paçin zotërit e tij!
I begatë, i lulëzuar qoftë ai,
një të ardhme pastë plot me lumturi!*

Rezultatet e pritshme:

Nxënësi:

- veçon momentet kryesore të jetës dhe veprës së Naim Frashërit;
- respekton teknikat e recitimit gjatë leximit të një poezie;
- shpreh ndjenjat dhe përjetimet e tij rreth poezisë;
- analizon lidhjen shpirtërore të tij me atdheun;
- gjykon dhe vlerëson formën dhe gjuhën që ka zgjedhur poeti për t'u shprehur për atdheun;
- gjen epitetet në poezi dhe tregon funksionin e tyre;
- krahason rendin e zakonshëm me rendin e fjalëve në poezi (inversionet) dhe tregon se si shprehet më mirë ideja e poetit;
- shton në fjalorin e tij fjalë dhe shprehje që kanë lidhje me atdheun;
- krijon një skicë ose poezi të shkurtër për atdheun.

Koha e sugjeruar: 3 orë mësimore

Fusha që integrohen: Histori dhe gjeografi

Metodologjia: kllaster, stuhi mendimi, diagrami i Venit, rrjeti i diskutimit.

Materiale të nevojshme: fletë pune, foto të ndryshme, materiale informuese nga interneti etj.

Zhvillimi i veprimtarisë

Hapi i parë: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Kllaster

Mësuesi u kërkon nxënësve që në çift të plotësojnë një kllaster për atdheun: Çfarë është atdheu për ju? Nxënësit plotësojnë kllasterin dhe më pas lexojnë punët e tyre. Më pas mësuesja bën një përmbledhje të mendimeve të nxënësve për atdheun dhe plotëson një kllaster në një tabelë.

Stuhi mendimi

Mësuesi pyet nxënësit nëse dinë ndonjë emër shkrimtari që ka shkruar për atdheun (Naim Frashëri, Çajupi, Serembe, Fishta, Noli, Agolli etj.)

- Çfarë dini për Naim Frashërin?
- Në ç'kohë ka jetuar?
- Mbani mend ndonjë poezi ose vepër të tij? P.sh., a ju kujtohet ndonjë varg nga poema "Bagëti dhe bujqësi" (*ti Shqipëri më jep nder/ më jep emrin shqiptar*).

Hapi i dytë: Ndërtimi i njohurive të reja

Prezantimi i përgjithshëm për jetën dhe krijimtarinë e Naim Frashërit

Mësuesi në një bisedë hyrëse prezanton titullin e poezisë dhe autorin. Mësuesi thotë shkurtimisht disa të dhëna për jetën dhe veprën e autorit.

Naim Frashëri u lind më 1846 në Frashër të Përmetit dhe vdiq më 20 tetor 1900 në Stamboll, ku edhe u varros. Eshtrat e tij janë sjellë në Shqipëri në vitin 1937.

Naim Frashëri ishte poeti më i madh i Rilindjes Kombëtare Shqiptare, atdhetar, mendimtar dhe veprimtar i shquar i arsimit e i kulturës shqiptare.

Veprat më të njohura të Naim Frashërit janë:

Lulet e verës

Histori e Skënderbeut

Qerbelaja, Ëndërrimet, Fjalët e qiririt etj.

Lexim shprehës i poezisë

2-3 nxënës lexojnë poezinë duke iu përmbajtur teknikave të recitimit. Pyeten nxënësit për ndjesitë e para që iu krijon poezia.

- A ju pëlqeu kjo poezi?
- Çfarë ndjenjash ju shoqëruan?
- Mendoni se atdheu është i rëndësishëm për çdo njeri? Pse?


Fjalët e reja

Sqarohen kuptimet e fjalëve të reja dhe nxënësit formojnë fjali me to.

Të kuptuarit e tekstit

- Çfarë është atdheu për Naim Frashërin?

Mësuesja ndan nxënësit në grupe dhe secili grup plotëson në formën e një kllasteri se çfarë është atdheu për poetin.



Pasi nxënësit kanë plotësuar kllasterin për poetin, e krahasojnë atë me kllasterin e plotësuar në fillim të orës dhe më pas bëjnë krahasimet.

- Në cilat vargje poeti vë përballë atdheun me gjëra të tjera të vlefshme të jetës?
(*më je nënë, më je motër, më je vëlla*- familja është gjëja më e vlefshme e jetës)
- Cila dashuri fiton mbi çdo dashuri tjetër? Dashuria për atdheun fiton mbi çdo dashuri dhe kjo duket në vargjet: *“Nga s’ka rrotull më i shtrenjti ti më je/ Je m’i miri nga çdo gjë që ka ky dhe.”*
- Cilat janë vargjet që tregojnë se atdheu është vendlindja e nënës? (*ty përditë nëna ime të ka parë/dheu yt në fund atë e pati marrë/numëruar t’i pat lulet syri i saj/ tek ti lindi, tek ti vdiq ajo pastaj*)
- Cilat janë vargjet që tregojnë se në atdhe janë varret e stërgjyshërve? (*ti ke parë gjysh stërgjyshërit e mi/ dhe eshtrat e tyre tretur i ke ti*)
- A ka në lidhjet poet-atdhe interesa ekonomike? Në asnjë varg nuk tregohet që në lidhjen poet-atdhe ka interesa ekonomike. Lidhja është shpirtërore.
- Paraqitni në një tabelë detajet me të cilat shprehet jeta dhe vdekja?

Jeta	Vdekja
<ul style="list-style-type: none"> - Tek ti lindi - pranë teje patën qeshur, patën qarë - begatoje këtë vend - epu njerëzve mbrothësi - gaz paçin përherë zotërit e tij - një të ardhme pastë plot lumturi 	<ul style="list-style-type: none"> - Tek ti vdiq ajo pastaj - Dhe eshtrat e tyre, tretur i ke ti - Nëna ime vdiq

Gjuha e poezisë

- Gjeni në poezi fjalën *nënë* dhe përcaktoni kuptimet e kësaj fjalë në secilin rast
Nënë- grua që ka lindur fëmijë (mëmë)

Nënë- atdhe

- Si është formuar fjala *faqehënë*? Çfarë kuptimi ka ajo? Është fjalë e përbëre dhe ka kuptimin: e bukur, e magjishme, e ndritshme etj.
- Mësuesi lexon një varg si p.sh.: *nga ç'ka rrotull më i shtrenjtë ti më je*. Më pas i pyet për rendin e fjalëve.
- Cili do të ishte rendi i zakonshëm? (ti je më i shtrenjtë nga ç'ka rrotull).
- Pse është ky rendi i zakonshëm? (rendi i zakonshëm: kryefjalë-kallëzues-gjymtyrë të dyta)
Mësuesi i pyet për ndryshimet.
- Cili përdorim ju duket më i bukur? Pse? (i poezisë, pasi theksohet fjala *i shtrenjtë*.)
Më pas mësuesi kërkon nga nxënësit që shembujt e dhënë në tekstin e nxënësit t'i shkruajnë në rendin e zakonshëm (syri i saj t'i pat numëruar lulet, ti i ke tretur eshtrat e tyre).

Hapi i tretë: Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Recitime të poezisë “Atdheu”

Mësuesi i vë nxënësit të recitojnë përmendësh poezinë e Naimit duke u kujdesur që nxënësit të respektojnë teknikën e recitimit.

Rrëfime personale

Paraprakisht mësuesi ka kërkuar nga nxënësit që të pyesin edhe të afërmit e tyre dhe të rrëfejnë mallin për Shqipërinë ose Kosovën dhe të përshkruajnë ndjesitë e tyre për atdheun.

Nxënësit rrëfejnë përvojat e tyre ose të tjerëve në raport me atdheun . Para se të fillojnë mësuesi u kujton që duhet të jenë të qartë dhe të kuptueshëm, të shoqërojnë të folurin me gjestet dhe mimikën e duhur.

Pasurimi i fjalorit (alfabeti i njëpasnjëshëm në tryezë të rrumbullakët)

Mësuesi u kujton nxënësve që gjatë kësaj ore kanë përdorur shumë fjalë dhe shprehje për atdheun. Ai prezanton një tabelë me shkronjat e alfabetit dhe u kërkon nxënësve (që i ndan në grupe) të shënojnë sa më shumë fjalë që kanë lidhje me atdheun.

A atdhe Albania Atë	B Berat Bajram Curri	C	Ç	D Durrës Dibër	Dh
E	Ë	F	G	Gj	H
I	J	K	L	Li	M
N	Nj	O	P	Q	Rr
Rr	S	Sh	T	Th	U
V	X	Xh	Y	Z	Zh

Detyrë shtëpie: Sillni në klasë objekte ose dhurata të vogla që i keni në shtëpi dhe që ju kujtojnë atdheun.

Hapi i katërt: Konkluzionet e kësaj veprimtarie mësimore.

Lënda HISTORI

3.1 Veprimtari Mësimore Nr. 1

Tema: Shqiptarët Në Lashtësi

Rezultate të pritshme:

Nxënësi/ja:

- Përshkruan origjinën e popullit shqiptar.
- Tregon në hartë shtrirjen gjeografike të popullit shqiptar në lashtësi dhe sot.
- Shfrytëzon burime të ndryshme informacioni për vazhdimësinë iliro-shqiptare, për të përshkruar qytetërimin ilir si pjesë e qytetërimit botëror në të njëjtën periudhë historike etj.
- Lidh të shkuarën me të tashmen.

Koha e sugjeruar: 2 orë

Fusha që integrohen: Gjuhët dhe komunikimi, arte, tik

Materiale të nevojshme: Harta e shtrirjes së fiseve ilire, foto nga qyteti i antik i Butrintit, Bylisit, Apolonisë.

Zhvillimi i veprimtarisë:

Hapi i parë:

Mësuesi/ja shkruan në tabelë termat

Ilirë *Shqiptarë*

Dhe kërkon nga nxënësit të tregojnë çfarë dinë për ilirët dhe shqiptarët dhe ti shkruajnë ato në tabelë.

Informacionet e dhëna nga nxënësit diskutohen dhe vlerësohen përgjigjet e sakta.

Hapi i dytë:

Mësuesi/ja kërkon nga nxënësit të ndarë në çifte që të aksesojnë internetin dhe të kërkojnë informacion për:

1. Fiset ilire, shtrirjen e tyre dhe kohën kur ata jetonin në fise. Hartë të shtrirjes së tyre
2. Mbretëritë ilire dhe tregtia me vendet fqinje. Hartë të shtrirjes së tyre
3. Të dhënat arkeologjike që vërtetojnë vazhdimësinë iliro-shqiptare;
4. Përshkrime të historianëve antikë për Ilirinë, ilirët dhe vazhdimësinë iliro-shqiptare.
5. Fotografji dhe materiale të shkruara për qytetet antike ilire dhe objekte të gjetura nga gërmimet arkeologjike në territoret e Shqipërisë dhe Kosovës.

Mësuesi/ja orienton nxënësit që pas gjetjes së informacionit nga burime të sigurta, ti ruajnë ato në një dosje të veçantë (folder).

Hapi i tretë:

Mësuesi/ja i ndan nxënësit në grupe kërkon nga ata që të hartojnë prezantimet e tyre si përmbledhje e informacionit të gjetur.

Grupi 1: Fiset dhe mbretëritë ilire, shtrirja dhe roli i tyre .

Grupi 2: Vazhdimësia iliro –shqiptare.

Grupi 3: Ndikimi i qytetërimit grek dhe romak në qytetërimin ilir.

Hapi i katërt:

Nxënësit prezantojnë punimet e tyre në forma të ndryshme dhe çdo prezantim regjistrohet nga mësuesi/ja për të përgatitur një dokumentar.

Hapi i pestë:

Mësuesi/ja shfaq në videoprojektor pamje të qyteteve antike si pjesë të qyteteve të sotme.

*Detyrë:*Lexoni veprën “Kalorësit dardan” të autorit Moikom Zeqo.

*Vlerësimi:*Mësuesi/ja vlerëson kontributin e nxënësve për të gjithë procesin mësimor, për pyetjet, përgjigjet, aksesimin e burimeve, përzgjedhjen e materialit dhe prezantimin e tij.

Ide për vazhdimësinë e veprimtarisë: Për të realizuar orët në vazhdim mësuesi/ja mund të përdorë muzeun virtual ku nxënësit gjejnë fotografi dhe vendosin në të të dhëna identifikuese(datën dhe ngjarjen) , realizojnë punë audio-vizuale , vizuale, (prezantime, dokumentarë) për të ndërtuar ngjarjet dhe për të bërë interpretimin e tyre sipas temave të orëve mësimore për një periudhë historike të caktuar, p.sh për antikitetin apo mesjetën etj.

3.2 Veprimtari Mësimore Nr. 2

Tema: Gjergj Kastrioti Skënderbeu

Rezultate të pritshme:

Nxënësi/ja:

- Identifikon rolin e Gjergj Kastriotit Skënderbeut në bashkimin e shqiptarëve dhe organizimin e shtetit shqiptar.
- Përshkruan kontributin e Gjergj Kastrioti Skënderbeu në luftën kundër pushtuesve osmanë.
- Shfrytëzon burime të ndryshme informacioni dhe përshkruani rolin e Skënderbeut në mbrojtje të trojeve shqiptare dhe Evropës nga pushtimi i Perandorisë Osmane.
- Vlerëson figurën e Skënderbeut

Koha e sugjeruar: 1 orë

Fusha që integrohen: Gjuhët dhe komunikimi, Arte, Tik

Materiale të nevojshme: Pjesë nga filmi shqiptar “Skënderbeu”; Hartë e Perandorisë Osmane; Foto nga betejat e shqiptarëve kundër pushtuesve osmane, foto të monumenteve dhe busteve të Skënderbeut në Shqipëri, Kosovë dhe vende të tjera të Evropës dhe të botës.

Zhvillimi i veprimtarisë:

Hapi i parë:

Mësuesi/ja shfaq në videoprojektor pjesë të për zgjedhura nga filmi shqiptar “Skënderbeu” dhe kërkon nga nxënësit ti përgjigjen pyetjeve:

1. Ku dhe kur lindi Gjergj Kastriot Skënderbeu?
2. Pse u mor peng Skënderbeu nga turqit osmanë?
3. Përshkruaj situatën në të cilën ndodheshin shqiptarët para ardhjes së Skënderbeut?
4. Cilat ishin arsyet që e shtynë Skënderbeun të kthehej në vendin e tij?
5. Cilat janë vendimet që mori Kuvendi i Lezhës?
6. Trego betejat e drejtuara nga Skënderbeu kundër pushtuesve osmanë.
7. Përshkruaj betejat e fituara nga shqiptarët nën udhëheqjen e Skënderbeut.

Informacionet e dhëna nga nxënësit diskutohen dhe vlerësohen përgjigjet e sakta.

Hapi i dytë:

Mësuesi/ja i ndanë nxënësit në çifte dhe iu shpërndan fletë A4 me pjesë nga romani “Skënderbeu” i autorit Sabri Godo. Gjithashtu kërkon nga nxënësit që në materialin e dhënë në fletë A4 dhe në internet të kërkojnë informacion për:

1. Tiparet e shtetit shqiptar të formuar nga Skënderbeu dhe rëndësia e tij në luftën kundër pushtuesve osman.
2. Betejat e zhvilluara mes shqiptarëve dhe turqve osmanë gjatë kohës së Skënderbeut dhe shkaqet e pasojat e këtyre betejave.
3. Roli i Skënderbeut në mbrojtje të trojeve shqiptare.
4. Roli i Skënderbeut si mbrojtës i Evropës nga pushtimi osman.

Mësuesi/ja orienton nxënësit që pas gjetjes së informacionit nga burime të sigurta (internet dhe fletët e printuara), ti ruajnë ato në një dosje të veçantë (folder).

Hapi i tretë:

Mësuesi/ja kërkon nga nxënësit të përgatisin një ese argumentuese me informacionet e gjetura, deri në 20 rreshta. Në përmbajtje të esesë do të jenë foto nga betejat e shqiptarëve kundër

pushtuesve osmane, foto të monumenteve dhe busteve të Skënderbeut në Shqipëri, Kosovë dhe vende të tjera të Evropës dhe të botës.

Hapi i katërt:

Nxënësit prezantojnë punimet, diskutojnë rreth tyre dhe i vlerësojnë ato.

Me punimet dhe fotot e vlerësuara si më të mira përgatitet një stendë.

Detyrë: Përgatisni një album për heroin tonë Gjergj Kastriot Skënderbeu.

Vlerësimi: Mësuesi/ja vlerëson kontributin e nxënësve për të gjithë procesin mësimor, për pyetjet, përgjigjet, aksesimin e burimeve, përzgjedhjen e materialit, esenë argumentuese, prezantimin etj.

Ide për vazhdimësinë e veprimtarisë: Për të realizuar orët në vazhdim mësuesi/ja mund të përdorë Albumin virtual ku nxënësit gjejnë fotografi dhe vendosin në të të dhëna identifikuese (datën dhe ngjarjen), për të ndërtuar ngjarjet dhe për të bërë interpretimin e tyre sipas temave të orëve mësimore që i përkasin tematikës Shqiptarët në hapësirë dhe kohë.

3.3 Veprimtari Mësimore Nr. 3

Tema: Monumentet Kryesore Historike Të Atdheut Tim

Rezultate të pritshme:

Nxënësi/ja:

- Përcakton vendndodhjen e monumenteve kryesore arkeologjike në Atdhe.
- Vlerëson kulturën materiale dhe shpirtërore të shqiptarëve dhe rëndësinë e monumenteve kulturor dhe historik.

Koha e sugjeruar: 1 orë

Fusha që integrohen: Gjuhët dhe komunikimi, Arte, TIK

Materiale të nevojshme: Fotografi nga monumente arkeologjike (Butrinti, Apolonia, Dyrrahu, Ulpiana etj). Fotografi të veshjeve popullore, instrumenteve të muzikës popullore, të valleve popullore.

Zhvillimi i veprimtarisë:

Një javë para zhvillimit të temës mësuesi/ja i kërkon nxënësve të sjellin fotografi ose video nga vizitat në vendin e origjinës, pjesëmarrjen në festa dhe gëzime në vendin e origjinës dhe në vendin ku jetojnë.

Hapi i parë:

Mësuesi/ja mbledh materialet e sjella nga nxënësit dhe prezanton në power point ose video pamje nga qytetet antike si Butrinti, Apolonia, Dyrrahu, Ulpiana etj, dhe e ndërpret atë pas prezantimit të një qyteti dhe kërkon nga nxënësit që të tregojnë monumentet që panë në materialin prezantues.

Pas prezantimit mësuesi/ja vendos në një kënd të tabelës fotot që nxënësit kanë bërë në këto qytete.

Hapi i dytë:

Mësuesi/ja shënon në tabelë termat:

Kulturë materiale

kulturë shpirtërore

Dhe kërkon nga nxënësit të shkruajnë në tabelë njohuritë që ata kanë për këto përkufizime dhe së bashku diskutojnë dhe përkufizojnë saktë termat kulturë materiale dhe shpirtërore.

Hapi i tretë:

Mësuesi/ja i ndan nxënësit në grupe dhe i shpërndan foto nga veshjet, instrumentet dhe vallet popullore që nxënësit kanë sjellë si edhe u kërkon atyre të kërkojnë në internet foto të tjera në lidhje me veshjet, instrumentet, vallet, këngët, legjendat të popullit tonë dhe kërkon nga nxënësit ti ndajnë sipas zonave që i përkasin këto e elemente të kulturës materiale dhe shpirtërore të vendit tonë.

Pasi nxënësit kanë përfunduar kërkimin i orienton që të përgatisin materialet prezantuese.

Grupi 1: Album me fotografi për veshjet popullore të ndara sipas zonave ku përdoren.

Grupi 2: Album me instrumentet dhe vallet të ndara sipas zonave që i përdorin.

Grupi 3: Të klasifikojnë këngët dhe legjendat sipas zonave.

Hapi i katërt: Nxënësit prezantojnë punimet e tyre dhe diskutojnë rreth tyre.

Me punimet dhe fotot e vlerësuara si më të mira përgatitet një fotomontazh.

Detyrë: Përgatisni një album me fotografi për monumentet arkeologjike duke i shpjeguar ato.

Vlerësimi: Mësuesi/ja vlerëson kontributin e nxënësve për të gjithë procesin mësimor, për pyetjet, përgjigjet, aksesimin e burimeve, përzgjedhjen e materialit, prezantimin etj.

Ide për vazhdimësinë e veprimtarisë: Për të realizuar orët në vazhdim mësuesi/ja mund të përdorë Muzeun virtual ku nxënësit vendosin fotografi, video dhe materiale të shkruara për tematikën “Kultura dhe shoqëria”.

3.4 Veprimtari Mësimore Nr. 4

Tema: Figura Historike

Rezultate të pritshme:

Nxënësi/ja:

- Kërkon dhe përzgjedh materialin për figurën e përzgjedhur historike.
- Përdor burimet e shkruara për portretizimin e figurës historike.
- Vlerëson burimet për vlefshmërinë dhe besueshmërinë e tyre.
- Ndërton njohuri, aftësi dhe qëndrime për figurën e përzgjedhur historike dhe rolin historik të saj, duke përdorur burimet historike, si fotografi bibliografi, etj.
- Formulon dhe drejton pyetje për figurën e përzgjedhur historike.
- Njeh dhe vlerëson figurat e rëndësishme historike.
- Tregon rolin e figurës së përzgjedhur historike në ngjarjet e kohës.
- Zhvillon perspektivën historike në vëzhgimin e kësaj figure.
- Komunikon (me shkrim, me gojë, vizualisht) rolin e figurës së përzgjedhur historike, përmes përdorimit të kompjuterit, duke përdorur fjalorin e përshtatshëm historik.

Koha e sugjeruar: 2 orë

Fusha që integrohen: Gjuhët dhe komunikimi, Arte, TIK, Qytetari

Materiale të nevojshme: Hartë historike, enciklopedi, gazeta, revista, burime informacione të marra nga interneti. Kompjuter. Njohuritë paraprake që ka nxënësi mbi figura të ndryshme historike dhe ngjarje që lidhen me këto figura.

Zhvillimi i veprimtarisë

Figurat historike janë veprimtari që mund të zhvillohen përgjatë çdo tematike mësimore në lëndën e historisë. Nëpërmjet njohjes së këtyre figurave historike nxënësit ndërtojnë vetë ngjarjet e kohës që lidhen me figurën historik dhe bëjnë interpretimin e tyre duke mbajtur qëndrim ndaj ngjarjeve historike nëpërmjet vlerësimit të rolit që ka luajtur figura e përzgjedhur historike.

Një javë para zhvillimit të temës mësuesi/ja i kërkon nxënësve në klasë të zgjedhin një figurë historike (*nga historia e shqiptarëve në periudha të ndryshme*) që ju pëlqen dhe të kërkojnë informacion për figurën që ata kanë përzgjedhur.

Hapat që kryen mësuesi:

- Prezanton rezultatet e të nxënit dhe propozon veprimtarinë, në përmbushje të interesave të nxënësit.
- Lehtëson organizimin e mjedisit (burimet materiale, kohën, grupet ose individët).
- Verifikon përzgjedhjen dhe kuptimin nga nxënësit të veprimtarisë dhe të rezultateve të të nxënit.
- Vëzhgon strategjitë që përdor nxënësi për përzgjedhjen, organizimin, përpunimin dhe prezantimin e informacionit.
- Vëzhgon shkallën e pjesëmarrjes së nxënësit në diskutim dhe reflektimit në lidhje me produktin.
- Vëzhgon përpjekjen e nxënësve për nxjerrjen e konkluzioneve.

Pyetje për diskutim

- Cila janë ngjarjet historike që i atribuohen figurës historike të përzgjedhur?
- Cilat janë tiparet e përbashkëta që i karakterizojnë figura të ndryshme historike të përzgjedhura?
- Cilat është roli i figurës historike në ngjarjet e kohës?
- Si interpretohet sot roli i kësaj figure në histori?

Hapi i parë:

Mësuesi dhe nxënësit shkojnë në sallën e kompjuterit për të hulumtuar figurat historike dhe ngjarjet që u përkasin secilës figurë të përzgjedhur.

Nxënësit, të ndarë në grupe, identifikojnë burimet e ndryshme të informacionit të cilat i shërbejnë për trajtimin e veprimtarisë. Hulumtojnë në këto burime për secilin nga kompetencat dhe konceptet bazë të kërkimit historik: koha dhe kronologjia, përdorimi i burimeve, ndryshimi dhe vazhdimësia, analiza shkak - pasojë; interpretimi historik; shumëllojshmëria etnike, kulturore dhe fetare, rëndësia historike, shpjegimi dhe komunikimi, në lidhje me figurën e përzgjedhur.

Hapi i dytë:

Secili grup nxënësish organizon informacionin duke trajtuar perspektivën e secilit koncept në lidhje me çështjen e identifikuar prej tyre.

- *Koha dhe kronologjia:* Hulumtojnë në likun e përcaktuar nga mësuesi për figurën historike të përzgjedhur, përcakton kohën dhe lidh ngjarjet që lidhen me këtë figurë;
- *Përdorimi i burimeve:* vendosin cilat burime janë të dobishme, cilat nuk janë dhe cilat duhen trajtuar me kujdes (me anë të një shembulli mësuesit udhëzojnë paraprakisht nxënësit)
- *Analiza shkak-pasojë & rëndësia:* analizojnë lidhjet shkak-pasojë për ndërtimin e ngjarjes duke u bazuar në burimet e gjetura; krijojnë fakte dhe dëshmi historike;

- *Interpretimi dhe komunikimi:* ndërton interpretime historike, vlerëson burimet dhe jep argumente; respekton mendimet e shokëve të tyre qofshin ato dhe të ndryshme nga të tyret; shpjegon dhe prezanton gjetjet nëpërmjet medieve të ndryshme (me shkrim; me gojë; TIK); diskuton me të tjerët për gjetjet dhe rezultatet e tyre; reflekton në punën e tyre idetë dhe sugjerimet, të cilat i shërbejnë përmirësimit e kësaj veprimtarie.

Secili grup nxënësish krijon një përmbledhje të shkurtër dhe koncize të temës duke u bazuar në burime por nuk deklaron emrin figurën së përzgjedhur.

Hapi i tretë:

Nxënësit prezantojnë në klasë gjetjet dhe pjesa tjetër e nxënësve duhet të gjejnë se për cilën figurë historike bëhet fjalë.

Secili grup nxënësish paraqet figurën historike nëpërmjet tregimit të ngjarjeve, pamjeve, fotove dhe u përgjigjet pyetjeve pas prezantimit. Ai luan rolin e figurës historike që ka përzgjedhur duke e portretizuar atë (në stilin e veshjes, ndonjë objekt të kohës, pamjen etj), por pa treguar në klasë se për cilën figurë historike bëhet fjalë.

Pjesa tjetër e klasës gjen se për cilin figurë historike bën fjalë ngjarja dhe pamjet e paraqitura.

Detyrë: Përgatisni një album me fotografi për momentet dhe ngjarjet më të rëndësishme që i atribuohen figurave të përzgjedhura historike.

Vlerësimi: Mësuesi/ja vlerëson kontributin e nxënësve për të gjithë procesin mësimor, për pyetjet, përgjigjet, aksesimin e burimeve, përzgjedhjen e materialit, prezantimin, gjetjen e figurës historike, vendosjen e saj në kohën e duhur dhe lidhjen e figurës historike me ngjarjet e kohës.

Ide për vazhdimësinë e veprimtarisë: Për të realizuar orët në vazhdim mësuesi/ja mund të përdorë Muzeun virtual ku nxënësit vendosin ese përshkruese (një përmbledhje koncize dhe informative të figurës historike), fotografi, video dhe materiale të shkruara për tematikat “Shqiptarët në hapësirë dhe në kohë” dhe “Identiteti im”

3.5 Veprimtari Mësimore Nr. 5

Tema: Data dhe Ngjarje të Rëndësishme

Rezultate të pritshme:

Nxënësi/ja:

- rendit kronologjikisht saktë datat historike duke i paraqitur ato grafikisht nëpërmjet kompjuterit ;
- përdor saktë konceptin e kohës për ngjarje të rëndësishme historike që i përkasin historisë së shqiptarëve;
- mendon në mënyrë kritike duke lidhur datën me ngjarjen ose figurën historike që i përket;

mirëkupton çdo nxënës në klasë;

Koha e sugjeruar: 1 orë

Fusha që integrohen: Gjuhët dhe komunikimi, Arte, Qytetari;

Materiale të nevojshme: 30 karta me data dhe ngjarje të rëndësishme të cilat nxënësit i njohin nga periudha të ndryshme historike; njohuritë që ka nxënësi mbi kuptimin e ndarjes së kohës në histori, periudhat historike, ngjarje të rëndësishme historike; kompjuter.

Zhvillimi i veprimtarisë:

Para zhvillimit të temës mësuesi/ja përgatit për secilin nxënës nga një kartë, ku në to janë vendosur data dhe ngjarje të rëndësishme historike që i përkasin historisë së shqiptarëve nga periudha të ndryshme si para erës sonë dhe në erën tonë. Ajo i shpërndan ato dhe organizon me nxënësit lojën “ulu-rrri në këmbë”.

Hapi i parë:

Nxënësit fillimisht mundohen t'i përgjigjen pyetjeve të mëposhtme:

- Si ndahet koha në histori?
- Çfarë kuptoni me kronologji?
- Çfarë kuptoni me termin pr.k. po me termin p.e.r.?
- Sa vite ka një shekull?
- Sa vite ka një dekadë?
- Sa dekada ka një shekull?
- Sa vite ka një mijëvjeçar?
- Sa shekuj ka një mijëvjeçar?
- Në cilin vit jemi?
- Cilit shekull i përket viti 1912 ps.k. ?
- Kur është dita e pavarësisë së Kosovës?
- Kujt shekulli i përket viti 2008 ps.k.
- Në cilin shekull jemi?
- Në cilin vit keni lindur ju?
- Në cilin shekull ka lindur motra/vëllai juaj?
- Në cilin vit ka lindur gjyshi juaj?
- Në cilin shekull ka lindur mamaja juaj?
- Në cilin shekull ka lindur gjyshja juaj?
- Cilat janë ngjarjet më të rëndësishme të atdheut tuaj?
- Kur datojnë këto ngjarje?

Hapi i dytë:

Pasi u përgjigjen pyetjeve të mësipërme, mësuesi/ja i fton nxënësit të vendosen në formë rrethi dhe i shpërndan çdo nxënës në klasë një kartë. Në secilën kartë mësuesi ka vendosur data të cilat përkojnë me ngjarje të rëndësishme historike (për të cilat nxënësi ka njohuri nga përvojat dhe mësimet e mëparshme). Datat dhe ngjarjet e vendosura në kartë janë nga periudha të ndryshme historike si para erës sonë dhe në erën tonë. P.sh.:

- Lufta e Enkelejve dhe Taulantëve kundër Aleksandërit të Maqedonisë. Taulantët zgjerohen në Veri deri në Lezhë, kurse në Jug deri në malësitë e Vlorës. (335 p.K.)
- Sundimi i Pirros, i cili bëhet pretendent në fronin maqedon dhe zhvillon fushatë ushtarake në Itali dhe në Sicili. 307-277 (p.K).
- Luftërat Iliro – Romake. (229 – 168 p. K)
- Lindi Gjergj Kastrioti – Skënderbeu. (1405 ps.K)
- Mbahet Kuvendi i Lezhës, me qëllim të bashkimit të vendit në luftën kundër turqve. Formohet Lidhja Shqiptare. (1444 ps.K)
- Beteja e Fushë-Kosovës(1389 ps.K)
- Lidhja e Prizrenit (10 qershor 1878)
- Lufta e Parë Botërore(1914 - 1918 ps.K)
- Pavarësia e Shqipërisë(28 nëntor 1912 ps.K)
- Lufta e Dytë Botërore. (1939-1945 ps.K)
- Pushtimi i Jugosllavisë prej Gjermanisë dhe bashkimi i një pjese të tokave shqiptare në Jugosllavi me Shqipërinë (1941)
- Konferenca e Bujanit (janar [1944](#) ps.K)
- Themelimi i [Universitetit të Prishtinës](#) ([1970](#) ps.K)
- Mbahet referendumi në të cilin populli shqiptar i Kosovës deklarohet për Kosovën shtet sovran dhe të pavarur. – Bashkësia Evropiane e shpall shpërbërjen e Jugosllavisë. (1991 ps.K)
- Shpërthimi i Lëvizjes studentore. (*8 dhjetor 1990* ps.K)
- *20 shkurt 1991* ps.K
- Kosova shtet i pavarur (17 shkurt 2008 ps.K)

Hapi i tretë:

Mësuesi/ja organizon me nxënësit lojën e mëposhtme.

Ajo ju drejtohet nxënësve të klasës:

- Uluni poshtë në qoftë se ju jeni në shekullin e 19 të erës sonë.
- Uluni poshtë në qoftë se ju jeni në shekullin e 21 të erës sonë.
- Uluni poshtë në qoftë se ju jeni në të njëjtën dekadë, si të tjerët.
- Uluni poshtë në qoftë se ju jeni brenda 50 viteve të fundit në histori.
- Uluni poshtë në qoftë se ju keni një datë e cila përkon me një luftë të zhvilluar ps.k.
- Uluni poshtë në qoftë se ju keni një datë e cila përkon me vitin e lindjes suaj.
- Uluni poshtë në qoftë se ju mendoni se data që ju keni nuk është historikisht e rëndësishme.

Hapi i katërt:

Mësuesja pyet nxënësit kush ka ngelur lart në këmbë dhe pse?

Mësuesi/ja ju kërkon nxënësve që të vendosen në resht në linjën e kohës nga data më e largët deri në datën më të afërt dhe e anasjelltë.

Detyrë: Mësuesja u kërkon nxënësve që të krijojnë nëpërmjet kompjuterit një grafik duke vendosur në mënyrë kronologjike në një rën anë datat e shkruara në kartat përkatëse dhe në anën tjetër ngjarjen që i përket.

Vlerësimi: Mësuesi/ja vlerëson kontributin e nxënësve për të gjithë procesin mësimor, për pyetjet, përgjigjet, kur lidhin saktë ngjarjet me data historike dhe e anasjelltë.

Lënda GJEOGRAFI

4.1 Veprimtari Mësimore Nr. 1

MODEL PROJEKTI

Tema e Projektit: Mundësitë e Integritit të Ardhshëm Politik dhe Ekonomik të Kosovës në Evropë

Rezultatet e pritshme të projektit:

Nxënësi:

- Sjell argumente të cilët mbështesin mundësitë e integritit të Kosovës në Evropë.
- Diskuton rreth mundësive dhe pengesave që ndikojnë në zgjerimin e hartës së njohjes.
- Rendit mundësitë e integritit ekonomik të Kosovës në rajon dhe Evropë.
- Ndan me të tjerët përvojat dhe njohuritë e përftuara nga vëzhgimet individuale.
- Demonstron bashkëpunim dhe qëndrim etik gjatë punës në grup.

Kohëzgjatja: 2-3 orë

Mjetet e nevojshme: Harta të ndryshme politike, historike, demografike të Kosovës; hartat skicë të Kosovës; vizore, lapsa me ngjyra, gomë, fletore shënimesh etj.

Zhvillimi i projektit:

Mësuesi e ndan klasën në grupe pune duke i dhënë secilit grup detyrën e tij sipas tematikave të mëposhtme:

Tematika e grupeve



Grupi I:

- Sjell argumente të ndryshme rreth mundësive të këtij integriti. Për realizimin e kësaj detyre grupi ka parasysh faktin që Republika e Kosovës është shteti më i ri në Evropë dhe është sfidë e rëndësishme integriti politik dhe ekonomik i saj në Evropë.

Grupi i II:

- Përshkruan alternativat dhe rrugët e integrimit të Kosovës në Evropë.
- Sjell harta që tregojnë vendet që e kanë njohur deri më sot Kosovën si shtet i pavarur.
- Diskuton rreth mundësive dhe pengesave që ndikojnë në zgjerimin e hartës së njohjes.

Grupi i III:

- Rendit mundësitë e integrimit ekonomik të Kosovës në rajon dhe Evropë.
- Krahason harta të ndryshme që paraqesin zhvillimin ekonomik të Kosovës me mundësitë që ofrojnë ato për integrimin ekonomik.
- Përshkruan pengesat dhe vështirësitë e këtij procesi.

Puna përgatitore: Nxënësit duhet të kenë mësuar më parë rreth temave që kanë të bëjnë me Kosovën; të dinë t'u përgjigjen pyetjeve; të kenë bërë detyrat në fund të këtyre temave, si dhe të njohin mirë të gjitha hartat e mëparshme.

Grupet, në varësi të tematikës së përzgjedhur, duhet të kenë në vëmendje çështjet e mëposhtme përgjatë kryerjes së detyrës:

-) Risjellin në kujtesë njohuritë që kanë marrë rreth Republikës së Kosovës.
-) Diskutojnë me shokun/shoqen e bankës mbi vendin dhe rolin e Kosovës në Ballkan, Mesdhe dhe Evropë.
-) Diskutojnë mbi faktorët që kanë ndikuar historikisht në zhvillimet politike dhe ekonomike të Kosovës.
-) Rendisin vështirësitë dhe pengesat që has aktualisht integrimi i Kosovës në Evropë.
-) Identifikojnë mundësitë dhe alternativat e integrimit të Kosovës në Evropë.
-) Nxjerrin përfundime mbi mundësitë dhe ecurinë e integrimit të Kosovës në Evropë.

Produkti i projektit prezantohet nga grupet e punës duke plotësuar njëri-tjetrin.

4.2 Veprimtari Mësimore Nr. 2

MODEL I NJË DETYRE KËRKIMORE

Tema: Mundësitë e Zhvillimit të Ekoturizmit (Turizmit Mbi Baza Natyrore) në Trevat Shqiptare

Rezultatet e pritshme të projektit:

Nxënësi:

- Identifikon llojet e ndryshme të turizmit që mund të zhvillohen në trevat shqiptare.
-) Analizon potencialet turistike që ofrojnë trevat shqiptare dhe faktorët që ndikojnë në zhvillimin e tyre.
-) Përshkruan rrugë dhe mundësi të zhvillimit të turizmit në vendin e tyre të prejardhjes duke evidentuar pengesa dhe vështirësi të këtij procesi.

- J) Demonstron aftësi për të punuar në grup, duke respektuar mendimin dhe punën e shokëve e shoqeve.

Koha mësimore: 3 orë

Mjetet e nevojshme: Harta të ndryshme të trevave shqiptare; hartat skicë të trevave shqiptare; vizore, lapsa me ngjyra, gomë, fletore shënimesh etj.

Zhvillimi i projektit:

Mësuesi e ndan klasën në grupe pune duke i dhënë secilit grup detyrën e tij sipas tematikave të mëposhtme:

Tematika e grupeve sipas zgjedhjes

Grupi I:

- Klasifikon faktorët që kanë çuar në ekzistencën e pasurive të shumta natyrore të trevave shqiptare.
- Rendit hapësirat, zonat dhe vendet me pasuritë më të shumta natyrore të trevave shqiptare.
- Hedh në hartën memece zonat dhe objektet më të rëndësishme natyrore të trevave shqiptare.

Grupi i II:

- Bën lidhjen e pasurive të veçanta natyrore të trevave shqiptare me mundësitë e përdorimit turistik të tyre.
- Rendit llojet e mundshme të zhvillimit të turizmit në hapësirat natyrore të trevave shqiptare dhe hidheni ato në hartë.
trevat shqiptare.

Grupi i III:

- Përcakton pengesat dhe vështirësitë për zhvillimin e turizmit.
- Debaton rreth problematikave që lindin nga ballafaqimi midis mbrojtjes së mjedisit dhe zhvillimit të turizmit.
- Rendit dhe analizon strategjitë dhe modelet që duhet të ndjekë zhvillimi i turizmit në trevat shqiptare.
- Shënon përfundimet që nxjerr nga analiza e bërë.

Grupi i IV:

- Grumbullon të dhëna dhe ilustrime të ndryshme rreth gjendjes së zhvillimit të turizmit në trevat shqiptare.
- Harton një projekt-ide mbi mundësinë e zhvillimit të turizmit në zonë gjeografike të trevave shqiptare që e njeh më mirë.


Puna përgatitore: Nxënësit duhet të kenë mësuar më parë rreth temave që kanë të bëjnë me natyrën dhe turizmin në trevat shqiptare; t' u jenë përgjigjur pyetjeve dhe të kenë bërë detyrat në fund të këtyre temave, si dhe të njohin mirë të gjitha ilustrimet e mëparshme.

Grupet, në varësi të tematikës së përzgjedhur, duhet të kenë në vëmendje çështjet e mëposhtme përgjatë kryerjes së detyrës:

-) Rendisin potencialet natyrore që ofrojnë trevat shqiptare për zhvillimin e turizmit.
-) Identifikojnë potencialet kulturore që ofrojnë trevat shqiptare për zhvillimin e turizmit.
-) Diskutojnë mbi mundësitë dhe gjendjen e shfrytëzimit turistik të potencialeve natyrore dhe kulturore.
-) Përcaktojnë në hartë zonat më të rëndësishme turistike të trevave shqiptare.
-) Shënojnë në legjendën e hartës shenjat përkatëse konvencionale.

Produkti i projektit prezantohet nga grupet e punës duke plotësuar njëri-tjetrin.

ILUSTRIME



Pamje e shtëpisë së Lidhjes së Prizrenit, e cila vizitohet çdo vit nga mijëra turistë.



Vend skijimi në malet e Kosovës
Kosovë



Qendër turistike klimaterike në

Numri i turistëve të huaj në Shqipëri në vite të ndryshme

Vitet	Turistë gjithë.	Netë turistike	Kohqëndrimi (ditë)	Turistë ditorë
1956	280	3 660	12.9	
1960	6 065	85 263	14.1	
1965	1 203	5 719	4.8	
1970	3 531	19 985	7.9	
1980	3 748	39 491	10.5	
1990	29 997	83 824	2.8	
1995	47 275	88 615	2.2	30 984
1996	56 276	143 854	2.6	50 000
1997	19 154	31 245	2.4	20 000
1998	30 694	64 215	2.5	30 000
2000	32 000	68 124	2.1	40 000
2003	41 000	84 253	3.3	50 000
2004	42 000	86 562	4.5	60 000
2005	46 000	94 876	3.1	70 000

Të ardhurat dhe shpenzimet nga turizmi ndërkombëtar (2000-2005)

Vitet	2000	2003	2004	2005
Të ardhura gjithsej (milione Euro)	421	461	591	692
Të ardhura nga turistët (euro)	10.125	11.225	14.069	15.043
Të ardhura nga vizitorët (euro)	712	828	916	925
Të ardhura për person (euro)	110	131	167	194
Shpenzime jashtë vendit (milione Euro)	325	432	515	635
Shpenzime për udhëtim (euro)	332	320	304	303
Shpenzime për person (euro)	112	123	145	178

Burimi: Organizata Botërore për Turizëm 2006, f. 193

4.3 Veprimtari Mësimore Nr. 3

MODEL MËSIMI

Titulli: Alpet e Shqipërisë

Rezultatet e pritshme:

Nxënësi:

- përshkruan pozitën gjeografike të Alpeve në hartën fizike të Shqipërisë dhe disa nga format kryesore të relievit;
- evidenton vlerat turistike të këtij rajoni;
- shpjegon veçoritë e popullsisë dhe të shpërndarjes së saj në këtë zonë.

Koha mësimore: 1 orë

Mjete të nevojshme:

Harta e Shqipërisë, tabakë letre, lapustila, ngjitës, gërshërë.

Zhvillimi i veprimtarisë:

Kjo veprimtari inkurajon punën e nxënësve në grup ku secili mësohet të respektojë e të vlerësojë mendimin e shokut. Vënia në pozicionin e reklamuesit i bën nxënësit të ekspozojnë sa më mirë vendin e tyre të origjinës, Shqipërinë.

Hapat:

Pasi është ndarë klasa në 5 grupe, mësuesi i cakton çdo grupi detyrën. Për të realizuar ndarjen në grupe përdorni forma të ndryshme në mënyrë që përbërja e tyre të mos jetë e njëjtë në çdo veprimtari. Prezantoni nxënësit me situatën e rastit si më poshtë:

Supozoni se punoni në një agjenci turistike dhe ju duhet të bëni një fletë palosje për Alpet e Shqipërisë. Në hartimin e tekstit duhet të keni parasysh të tërhiqni sa më shumë turistë për ta vizituar këtë zonë. Jeni të lirë në strukturimin e tekstit, por mbani parasysh që në të të përfshihen çështjet e mëposhtme:

-) ku shtrihen Alpet shqiptare;
-) cilat forma të relievit mbizotërojnë, duke përmendur disa male dhe lugina;
-) tipi i klimës;
-) lumenjtë kryesorë;
-) bota shtazore e bimore;
-) bukuritë që ofron relievi;
-) popullsia e kësaj zone;
-) qendrat kryesore;
-) si paraqitet gjendja e ndotjes së mjedisit;

-) e ardhmja e këtij rajoni.
- Për të lehtësuar kuptimin e detyrës, mësuesi shkruan në dërrasën e zezë çështjet që duhet të pasqyrohen në tekstin që do të shkruhet.
- Pasi u lihet koha e mjaftueshme për të realizuar detyrën, secili grup prezanton punën e tij e cila është paraqitur në tabakët e letrës që afishohen në muret e klasës. Në fund, mësuesi bën përmbledhjen duke shtuar njohuri të reja.
- Më pas kalohet në diskutimin mbi bazën e pyetjeve:
 -) A ka resurse të mjaftueshme ky rajon për zhvillimin e turizmit?
 -) Po në të ardhmen ç'mund të ofrojë ky rajon?
 -) A njihni rajone turistike në botë të ngjashme për nga kushtet fiziko-geografike me alpet tona?

4.4 Veprimtari Mësimore Nr. 4

MODEL MËSIMI

Tema: Veçoritë e Urbanizimit të Rajonit Perëndimor Të Shqipërisë dhe Pasojat e Tij

Rezultatet e pritshme:

Nxënësi:

- përshkruan shtrirjen e Rajonit Perëndimor dhe të pjesëve përbërëse të tij, format e relievit, objektet hidrografike;
- shpjegon përhapjen e popullsisë, të qendrave të banuara e të ekonomisë.

Koha mësimore: 1 orë

Mjetet e nevojshme: Harta e Shqipërisë në shkallën 1:200.000, në të cilën gjendet edhe Rajoni Perëndimor; atlase, fletore pune, si dhe harta memece të Shqipërisë dhe të rajonit; të dhëna mbi klimën, hidrografinë, popullsinë dhe ekonominë e rajonit; vizore, lapsa me ngjyra, gomë, letër milimetrike, bllok shënimesh etj.

Zhvillimi i veprimtarisë:

Për realizimin me sukses të kësaj pune praktike, duhet që nxënësit t'i përgjigjen saktë pyetjeve të vendosura në fund të mësimëve të Rajonit Perëndimor. Në orën e punës praktike, mbi bazën e rezultateve, përpiquni të nxirrni disa përfundime mbi veçoritë gjeografike të rajonit.

Zgjidhni këto detyra:

- J) Përcaktoni shtrirjen e Rajonit Perëndimor në hartën fizike të Shqipërisë. Hidhni në këto harta rrugët kryesore automobilistike, Korridorin Tetë dhe linjat hekurudhore që përshkojnë rajonin. Gjykoni për vlerat e pozitës gjeografike në zhvillimin e rajonit.
- J) Në hartën fizike të rajonit gjeni vargjet fushat dhe kodrat kryesore të tij. Bëni të njëjtën gjë edhe për lumenjtë që përshkojnë këtë rajon. Hidhni ato në hartën memece të rajonit.
- J) Në bazë të të dhënave mbi popullsinë e rajonit, nga tabela e mëposhtme apo të siguruar vetë, ndërtoni grafikë dhe harta që shprehin gjendjen e zhvillimit demografik të rajonit. Shpjegoni arsyet se përse rajoni në tërësi, dhe rrethe të veçanta të tij, janë më të populluarit në Shqipëri.
- J) Radhitni qytetet e Rajonit Perëndimor sipas numrit të popullsisë, hidhni ata me shenja të veçanta në hartë.
- J) Hidhni në hartën e rajonit zonat bujqësore, si dhe degët dhe qendrat kryesore industriale të tij.
- J) Hidhni në hartë zonat më të mundshme për zhvillimin e turizmit në Rajonit Perëndimor, dhe shpjegoni arsyet me të cilat lidhet ky zhvillim.

4.5 Veprimtari Mësimore Nr. 5

MODEL MËSIMI

Tema: Relievi dhe Tiparet e Tij në Vendbanimin e të Parëve të Mi

Rezultatet e pritshme:

Nxënësi:

- përshkruan tiparet e relievit të vendbanimit të të parëve, duke veçuar elementë të veçantë;
- interpreton në hartë tiparet e relievit në vendin e origjinës ;
- mbledh dhe përpunon informacionin mbi përbërësit kryesorë të relievit në vendbanimin e tij duke shfrytëzuar burime të ndryshme informacioni.

Koha mësimore: 1 orë

Mjetet e nevojshme: Harta e Shqipërisë në shkallën 1:200.000; atlase, fletore pune, si dhe harta skicë të rajonit; vizore, lapsa me ngjyra, gomë, letër milimetrike, bllok shënimesh etj.

Zhvillimi i veprimtarisë:

- J) Rrjeti i diskutimit:
Mësuesi/ja ekspozon në klasë hartën e Shqipërisë dhe fton nxënësit/et të diskutojnë mbi pozitën gjeografike të rajonit. “Diskutojmë: Pozita gjeografike që ka Shqipëria,

ka ndikuar shumë në tiparet fiziko-gjeografike të saj. Falë kësaj pozite gjeografike, në Shqipëri ka reliev dhe përbërje shkëmbore të larmishme, pasuri minerale, ka shumë pasuri ujore, një klimë të përshtatshme për jetesë, toka pjellore, botë të gjallë të shumëllojshme, etj. Cilat janë tiparet kryesore të relievit të Shqipërisë. Po në vendbanimin e të parëve? Nxënësit/et përshkruajnë, diskutojnë, mbi bazën e atyre njohurive që kanë mbi zonat që kanë parë në Shqipëri (nga emisione të ndryshme televizive, nga media, revista etj) dhe në vendbanimin e të parëve.

-) Vëzhgo – Analizo – Diskuto: Mësuesja fton nxënësit/et të shohin hartën dhe të njihen me tiparet kryesore të relievit të Shqipërisë dhe me përbërjen e truallit të saj. Diskuton me ta mbi informacionin e dhënë. Më pas mësuesi/ja u jep nxënësve me shënime (të printuara) të dhëna mbi tiparet kryesore të relievit dhe me përbërjen e truallit të vendbanimit të tyre. Bazuar në to, nxënësit diskutojnë, krahasojnë, vlerësojnë relievin.
-) Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/ Punë në grup: Orientohen nxënësit/et të hulumtojnë, vëzhgojnë dhe të prezantojnë mbi vendbanimin e të parëve. Nxënësit punojnë dhe diskutojnë në grup.

Lënda ARTI PAMOR

5.1 Veprimtari Mësimore Nr. 1

Tema Mësimore: Flamuri Ynë Kombëtar

Rezultatet e pritshme:

-) zbulon karakteristikat dalluese të flamurit kombëtar dhe zhvillimin historik të tij, që nga koha e Skënderbeut e deri më sot;
-) vizaton flamurin kombëtar duke pasur parasysh simetrinë e tij dhe raportin e dy ngjyrave (e kuqe për sfondin dhe e zezë për shqiponjën);
-) diskuton mbi mënyrën e realizimit të flamurit dhe vlerëson punën e tij/saj dhe të shokut/qes.

Koha e sugjeruar : 1 orë mësimore

Fusha që integrohen: muzika, gjuha amtare, historia.

Materiale të nevojshme: CD me himnin e flamurit; imazhe që tregojnë zhvillimin e flamurit deri në ditët e sotme; laps, letër, temper.

Zhvillimi i veprimtarisë:

Nxënësit dëgjojnë himnin e flamurit duke e nderuar atë, ndërsa në ekran shfaqet flamuri kombëtar duke u valëvitur.

Çfarë simbolizon flamuri për ju? Po për kombin tonë?

Nxënësit diskutojnë për rëndësinë simbolike që flamuri ka për identitetin kombëtar.

Nëpërmjet imazheve të ndryshme mësuesi shpjegon zhvillimin historik të flamurit që nga koha e Skënderbeut e deri në ditët e sotme. Nxënësit vëzhgojnë flamurin që nga koha e Skënderbeut, flamurin që u ngrit në Vlorë nga Ismail Qemali dhe diskutojnë mbi njohuritë që kanë për këto ngjarje kyçe për historinë e kombit tonë.

Nxënësit vizatojnë flamurin, duke ndarë mirë raportin midis hapësirës së kuqe të sfondit dhe atë të shqiponjës me dy krerë. Mësuesi/ja i orienton që shqiponja është simetrike dhe si e tillë mjafton të vizatohet saktë në njërin anë e më pas të kopjohet me saktësi në anën tjetër. Mbas nxënësit mbarojnë vizatimin e saktë të shqiponjës e ngjyrosin atë duke përdorur dy ngjyrat e tij, të kuqen dhe të zezën. Për ngjyrosjen ata përdorin ngjyrat e temperës për të arritur një rezultat sa më të kënaqshëm. (Një mënyrë tjetër për realizimin e shqiponjës është edhe përdorimi i letrave me ngjyra, e zezë dhe e kuqe)

Vlerësimi:

Mbas realizimit të vizatimit të flamurit, nxënësit i varin punimet e tyre në klasë duke krijuar një atmosferë festive (si në rastin e festave kombëtare). Ata diskutojnë për mënyrën e realizimit dhe vlerësojnë punën e tyre dhe të shokëve.

5.2 Veprimtari Mësimore Nr. 2

TEMA MËSIMORE: Banesa Karakteristike Shqiptare – Kulla/Banesa Qytetare

Rezultatet e pritshme:

-) dallon karakteristikat e banesave qytetare tradicionale shqiptare si ato të Beratit, Gjirokastrës, Prizrenit, etj;
-) zbulon elementet arkitektonikë dhe termat etnografikë të këtyre ndërtesave;
-) vizaton një banesë ose grup banesash duke paraqitur karakteristikat arkitektonike dalluese;
-) diskuton mbi karakteristikat arkitektonike të përbashkëta dhe të veçanta të banesave të qyteteve të ndryshme.

Koha e sugjeruar: 2 orë

Fusha që integrohen: gjuha, gjeografia, historia.

Materiale të nevojshme: fotografi me banesa karakteristike nga qytete të ndryshme (shtëpi në grup, shtëpi më vete, hapësirat e brendshme, detaje; laps, letër, bojëra sipas dëshirës.

Zhvillimi i veprimtarisë:

Mësimi fillon me shfaqjen e imazheve të disa banesave karakteristike dhe diskutimin rreth tyre. Cilat janë banesat qytetare karakteristike shqiptare që ju njihni? A keni parë të tilla në qytetin apo fshatin tuaj në atdhe? A e keni vizituar ndonjëherë qytetin e Gjirokastrës, Beratit, Prizrenit, apo a keni parë imazhe të këtyre qyteteve? Çfarë dini ju për to?

Pjesa e parë

Nëpërmjet imazheve të ndryshme fotografike nxënësit njihen me qytete shqiptare si Berati, Gjirokastra, Prizreni, etj. Nëpërmjet hartës ata zbulojnë vendndodhjen dhe karakteristikat gjeografike të këtyre qyteteve. Lidhja me terrenin ku ato janë ndërtuar është pjesë e rëndësishme e këtyre njohurive për të kuptuar harmoninë e arkitekturës me natyrën. Mësimi shoqërohet me një përshkrim historik të shkurtër të tyre duke theksuar që Berati dhe Gjirokastra tashmë janë pjesë e trashëgimisë kulturore botërore të mbrojtura nga UNESCO.

Më pas imazhet fokusohen në shtëpi të veçanta për të zbuluar karakteristikat e tyre arkitektonike, materialet e përdorura, formën e tyre dhe elemente të veçanta si dritaret, çatitë, katet, portat, etj.

Pjesa e dytë

Më pas ata zgjedhin të vizatojnë njërën nga shtëpitë tradicionale, duke pasqyruar karakteristikat e përgjithshme dhe detajet e tyre. Nxënësit realizojnë detaje të tilla arkitektonike si, dritaret, çatitë, dyert, teksturën e mureve (aty ku është e dukshme), etj., duke respektuar karakterin e përgjithshëm të ndërtesës. Nxënësit përdorin lapsin e plumbit për vizatimin dhe lapsat me ngjyra. *(teknika e vizatimit i ndihmon ata të paraqesin detajet e ndërtesave)*

Vlerësimi:

Nxënësit identifikojnë elementët e përbashkët dhe të veçantë të këtyre ndërtesave nëpërmjet krahasimit të tyre. Ata diskutojnë mbi karakteristikat e ndërtesës që kanë zgjedhur për të vizatuar.

Detyrë shtëpie:

Nxënësit zgjedhin për të vizatuar nga një element arkitektonik të përbashkët për tre shtëpi të qyteteve të ndryshme, p. sh., dritaren, derë, portën apo çatinë për të zbuluar karakteristikat e veçanta të këtyre detajeve.

Ide për vazhdimësinë e veprimtarisë: Kjo veprimtari mund të vazhdojë me njohjen e hapësirave të brendshme të këtyre banesave dhe mënyrën e organizimit të tyre. Kjo do të ndihmonte shumë nxënësit për një njohje më të thellë të mënyrës së jetesës së këtyre banorëve.

5.3 Veprimtari Mësimore Nr. 3

Tema Mësimore: Natyra Shqiptare në Stinë të Ndryshme

Rezultatet e pritshme:

-) zbulon larminë gjeografike dhe bukuritë e peizazhit shqiptar nga vende dhe stinë të ndryshme;
-) realizon një peizazh duke zgjedhur sipas dëshirës vendin dhe stinën;
-) diskuton mbi larminë dhe bukurinë e peizazhit shqiptar duke vlerësuar punën e tij/saj dhe të shokut/qes.

Koha e sugjeruar: 1 ose 2 orë mësimore

Fusha që integrohen: gjeografia, gjuha.

Materiale të nevojshme: imazhe të ndryshme fotografike nga Shqipëria dhe Kosova ku paraqiten peizazhe në stinë të ndryshme; laps, letër, akuarele ose temper.

Zhvillimi i veprimtarisë:

Nëpërmjet imazheve të ndryshme fotografike, të shfaqura në klasë, nxënësit zbulojnë dhe identifikojnë vende në stinë të ndryshme nga Shqipëria dhe Kosova. A i keni vizituar këto

vende më parë? Si paraqiten karakteristikat e stinëve në këto vende? A ka një teren të thyer gjeografik atdheu ynë?

Mësuesi/ja shpjegon terrenin e larmishëm të atdheut si bregdetin e bukur, malet e larta, fushat e kodrat. Shpjegon si duken ato në stinë të ndryshme. Mundësitë e shumta që ka atdheu ynë për zhvillimin e turizmit kulturor, etj.

Nxënësit nxiten të përzgjedhin peizazhin që duan të pasqyrojnë në punimet e tyre në një stinë të caktuar. Ata vizatojnë me laps duke bërë interpretimin e tyre personal për peizazhin e zgjedhur. Mësuesi tregon peizazhet e disa autorëve të njohur për të treguar mënyrën e tyre personale të interpretimit. Mbas vizatimit nxënësit përdorin bojërat e ujit (akuatela ose temper) në krijimet e tyre. Nëpërmjet ngjyrave ata nxiten të paraqesin karakteristikat dhe stinën e peizazhit.

Vlerësimi:

Pasi mbarojnë punimin nxënësit diskutojnë për mënyrën sesi e realizuan atë dhe vështirësitë që hasën. Ata shpjegojnë pse përzgjedhën peizazhin dhe stinën e caktuar dhe karakteristikat e tij. Nxënësit vlerësojnë punën e tyre dhe të tjerëve.

Detyrë shtëpie:

Në shtëpi nxënësit realizojnë përsëri të njëjtin peizazh por në një stinë tjetër për të kuptuar ndryshimet që ai pëson në stinë të ndryshme dhe përdorimin e ngjyrave specifike për ta paraqitur këtë.

5.4 Veprimtari Mësimore Nr. 4

Tema Mësimore: Motive Të Veshjeve Shqiptare

Rezultatet e pritshme:

-) zbulon larminë e motiveve dhe kombinimin e tyre në veshjet popullore;
-) përzgjedh dhe vizaton motive të ndryshme nga veshjet popullore;
-) realizon një vizatim dekorativ me motive duke ndjekur një ritëm të caktuar;
-) diskuton dhe vlerëson mënyrën e kombinimit të motiveve në punimin e tij/saj

Koha e sugjeruar: 2 orë mësimore

Fusha që integrohen: gjuha, gjeografia, (matematika)

Materiale të nevojshme: imazhe me motive nga veshje të ndryshme popullore; laps, letër, lapustila ose lapsa me ngjyra, vizore.

Zhvillimi i veprimtarisë:

Nëpërmjet imazheve fotografive nxënësit zbulojnë veshje të ndryshme popullore si jelekë, xhoke, këmisha, etj. (te zgjedhura për larminë e motiveve). A janë të njohura për ju këto veshje? Ku keni parë të tilla? A keni në familjen tuaj ndonjë të tillë të trashëguar nga gjyshja? A janë të pasura me zbukurime këto veshje?

Imazhet përqendrohen te motivet e qëndisura të veshjeve popullore. Mësuesi shpjegon llojet e ndryshme të motiveve si ato gjeometrike ashtu edhe ato me lule apo me kafshë. Nxënësit zbulojnë mënyrën sesi janë thjeshtëzuar dhe stilizuar ato. Për të kuptuar më mirë natyrën e çdo motivi ata vizatojnë disa prej tyre.

Më pas mësuesi shpjegon përhapjen kompozicionale të motivit në një veshje, ndërthurjen dhe rimin. Nxënësit inkurajohen të përzgjedhin një ose dy motive dhe të krijojnë një dekoracion duke interpretuar në mënyrë personale ndërthurjen dhe ritmin e motiveve. Në fillim nxënësit realizojnë vizatimin dhe kompozimin e motiveve duke përdorur edhe vizoren si mjet ndihmës. Më pas ata përzgjedhin raportet e ngjyrave duke u mbështetur te motivet e veshjeve.

Vlerësimi:

Mbas realizimit të detyrës nxënësit diskutojnë mbi motivet e përzgjedhura, mbi mënyrën sesi i kanë ndërthurur ato në dekoracionet e tyre dhe ritmin që kanë përdorur. Ata diskutojnë mbi bukurinë e këtyre motiveve dhe sesi ato mund të përdoren edhe sot për të zbukuruar pëlhura apo veshje të ndryshme.

Detyrë shtëpie:

Nxënësit realizojnë dekoracione me motive të tjera për të kuptuar larminë e motiveve popullore dhe të kombinimeve të tyre kompozicionale.

5.5 Veprimtari Mësimore Nr. 5

Tema Mësimore: Veshja Tradicionale Shqiptare

Rezultatet e pritshme:

-) Identifikon pesë tipet e veshjes popullore Shqiptare duke përdorur fjalorin e duhur etnografik;
-) Vizaton një veshje popullore duke paraqitur elementet e saj përbërës dhe ngjyrat karakteristike;
-) Vlerëson veshjen popullore si një element të rëndësishëm të trashëgimisë tonë kulturore.

Koha e sugjeruar: 2 orë mësimore

Fusha që integrohen: gjuha, gjeografia, historia.

Materiale të nevojshme: imazhe të pese tipave të veshjeve popullore; laps, letër, lapsa me ngjyra ose lapustila.

Zhvillimi i veprimtarisë:

Nëpërmjet imazheve të pesë tipave të veshjeve (për burra dhe gra) nxënësit nxiten të diskutojnë. A ju pëlqejnë veshjet popullore? Çfarë dini ju për to? A i njihni veshjet popullore shqiptare? Cilat janë veshjet që njihni?

Mësuesi/ja shpjegon veshjet popullore shqiptare të klasifikuara në pesë tipe si për gra ashtu edhe për burra. Çdo veshje merr emërtimin sipas pjesëve përbërëse si p.sh. veshjet për gra: “veshja me xhubletë” “veshja me këmishë të gjatë me një përparje”, “veshja me këmishë të gjatë me dy futa”, “veshja me mbështjellëse” dhe “veshja me brekushe”. Po ashtu edhe veshjet për burra: “veshja me fustanellë”, “veshja me këmishë të gjatë dhe çibun”, “veshja me tirq”, “veshja me brekushe” dhe “veshja me poture”. Nxënësit zbulojnë karakteristikat e veshjeve dhe shpërndarjen e tyre gjeografike. Çdo nxënës përzgjedh një nga veshjet popullore për ta vizatuar duke pasur parasysh elementet përbërës dhe mënyrën sesi ato lidhen me njëri tjetrin për të krijuar formën e përgjithshme. Më pas realizojnë zbukurimet dhe përdorin raportin e ngjyrave në përshtatje me veshjen që kanë zgjedhur.

Vlerësimi:

Nxënësit diskutojnë mbi veshjen popullore që kanë realizuar, elementet përbërës të tyre dhe kujt zone i përket. Ata diskutojnë mënyrën e realizimit dhe karakteristikat e veshjes që kanë dashur të theksojnë më shumë.

5.6 Veprimtari Mësimore Nr. 6

Tema Mësimore: Instrumenti Popullor Muzikor Shqiptar

Rezultatet e pritshme:

-) Identifikon disa nga veglat muzikore popullore për nga forma dhe elementet që e përbëjnë;
-) Vizaton një vegël muzikore popullore duke realizuar formën dhe elementet përbërës të saj;
-) Vlerëson veglat muzikore popullore si objekte të rëndësishme të trashëgimisë tonë si për nga vlerat muzikore ashtu edhe për nga vlerat estetike dhe artizanale që ato mbartin.

Koha e sugjeruar: 1 orë mësimore

Fusha që integrohen: muzika, gjuha, gjeografia, historia.

Materiale të nevojshme: fotografi të veglave të ndryshme muzikore; vegla muzikore popullore nëse është e mundur; laps, gomë, letër vizatimi.

Zhvillimi i veprimtarisë:

Nëpërmjet imazheve fotografike ku paraqiten vegla muzikore popullore ose vegla reale nëse është e mundur, nxënësit identifikojnë emërtimet e tyre si fyelli, klarineta, çiftelia, lahuta,

dajrja, daullja, etj. A i njihni ju këto vegla muzikore? Çfarë keni mësuar në lëndën e muzikës për këto vegla? Cila nga veglat ju pëlqen më shumë për nga tingulli? Po për nga forma?

Mësuesi/ja shpjegon veglat muzikore për nga forma dhe mënyra sesi përdoren, lidhjen midis formës dhe tingullit etj. Mësuesi vendos në formën e natyrës së qetë një ose dy vegla muzikore (nëse nuk ka vegla muzikore reale, ose nxënësit zgjedhin fotografinë e një vegle muzikore për të vizatuar). Nxënësit vizatojnë natyrën e qetë me veglat muzikore popullore duke pasur parasysh formën e tyre të përgjithshme, raportin që ato kanë me njëra-tjetrën dhe raportet midis elementeve të çdo vegle në vetvete. Nxënësit punojnë me laps të zi plumbi për të realizuar formën dhe detajet e veglave muzikore.

Vlerësimi:

Në fund të detyrës nxënësit diskutojnë mbi punën e bërë duke treguar elementet përbërës të veglave muzikore dhe formën e tyre në lidhje me tingullin.

5.7 Veprimtari Mësimore Nr. 7

Tema Mësimore: Urim Shokut/Shoqes Tim/e Në Shqipëri – Kartolinë

Rezultatet e pritshme:

-) krijon simbole të thjeshta në përshtatje me rastin e urimit;
-) realizon kartolinën e urimit për shokun/shoqen duke përdorur simbolikën e përshtatshme për urimin;
-) vlerëson rëndësinë e përzgjedhjes së imazhit apo simboleve dhe i përdor në kontekstin e duhur.

Koha e sugjeruar: 1 orë mësimore

Fusha që integrohen: gjuha, historia.

Materiale të nevojshme: laps, letër, ngjyra sipas dëshirës, apo materiale për kolazh.

Zhvillimi i veprimtarisë:

A keni krijuar miqësi kur keni shkuar për të vizituar atdheun? A keni dëshirë për ta ruajtur dhe për ta forcuar këtë miqësi me shokët e shoqet tuaj në atdhe? Cila është një nga mënyrat për të ruajtur lidhjet miqësore kur jeni larg? Secili nga ju mund të realizojë një kartolinë urimi për shokun apo shoqen për një rast të caktuar.

Mësuesi/ja shpjegon se kartolina mund të shoqërohet me një imazh apo një simbol të caktuar në përshtatje me rastin e urimit. Këto raste mund të jenë festa të ndryshme kombëtare, lokale apo edhe urime për ditëlindjen. Në fillim nxënësit realizojnë formatin e kartolinës, pra hapësirën e caktuar për imazhin dhe tekstin e shkruar. Secili nga nxënësit përzgjedh një imazh apo simbolikë të caktuar për rastin e urimit. Mësuesi i nxit ata të përdorin simbole kombëtare me rastin e festave apo edhe imazhe nga peizazhi, flora dhe fauna e atdheut. Imazhet e tyre mund të mbështeten edhe në kujtimet që ata kanë ndarë me shokun dhe shoqen apo kujtime

shumë personale. Nxënësit vizatojnë dhe më pas përdorin teknikën sipas dëshirës për të përfunduar kartolinën.

Vlerësimi:

Në fund të detyrës nxënësit diskutojnë për kartolinën që kanë realizuar. Ata tregojnë për miqësinë e tyre dhe arsyet e urimit që po dërgojnë. Nxënësit shpjegojnë arsyet e imazhit apo simbolit të përdorur në kartolinë në lidhje me rastin e urimit.